RAPORT I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS (V.N.M.)

OBJEKTI: **RIKONSTRUKSION DHE ASFALTIM I RRUGËS SË LAGJES KARRIQI**

ADRESA: **BASHKIA PRRENJAS , QARKU ELBASAN**



VLERESUESI V. N. M. :

DATA E VLERESIMIT: **TIRANE: JANAR 2026**

Besmira Niko

Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT

H Y R JE
OBJEKTIVI I VLERESIMIT

DATA E VLERËSIMIT POROSITËSI VLERËSUESI QËLLIMI I RAPORTIT
EMËRTIMI I PROJEKTIT TE IDEUAR
DOKUMENTAT E MARRA NË KONSIDERATË NË
VLERËSIM METODAT DHE TEKNIKAT E
VLERËSIMIT
Përqasja e Vleresuesit te VNM
KONFIRMIMI I EKZAMINIMIT FIZIK TË OBJEKTIT
BAZAT LIGJORE TË VLERËSIMIT (LIGJET DHE UDHËZIMET)

a) përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;

b) informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;

c) informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;

ç)një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;

d) informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;

dh) të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;

e) mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;

ë) masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

f) ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

Nr.	Shkurt		EMERTIMI I PLOTE SHQIP	EMERTIMI I PLOTE ANGLISHT
1	Shqip	Angl.		
2	RSH		Republika e Shqipërisë	
3	BE		Bashkimi Evropian	
4	ARM		Agjencia Rajonale e Mjedisit	
5	EM		Edukimi Mjedisor	
6	IM		Instituti i Mjedisit	
7	KQM		Komisioni Qytetar i Mjedisit	
8	KRM		Këshilli Rajonal të Mjedisit	
9	VNM		Vlerësimi i ndikimit në Mjedis	
10	ZVM		Zona Veçanërisht të Mbrojtura	
11	IHM		Instituti i Hidrometeorologjisë	
12	IALA		Shoqata Ndërkombëtare për Vlerësimin e Ndikumit	
13		ALARA	I ulët sa mund të arrihet në mënyrë të arsyeshme	As Loë As Reasonably Achievable."
14	KMZM		Komiteti i Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura	
15	Nr.	No.	Numër	
18	Sh.P.K		Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	
22	VKM		Vendim i Këshillit të Ministrave	
23	LAMMNG		Ligji për Administrimin Mjedisor të Mbet të Ngurta	
24	LAMR		Ligji për Administrimin e Mbetjeve të Rrezikshme	
25	LMAN		Ligji për Mbrojten e Ajrit nga Ndotja	
26	LMM		Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit	
28	OZHM		Objektivat e Zhvillimit të Mjedisit	
29	PLVM		Plan Lokal i Veprimit për Mjedisin	
30	LOFQV		Ligji për Organizimin e Qeverisjes Vendore	
31	LPM		Ligji për Largimin Publik të Mbeturinave	
32	LPSHP		Ligji për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor	
33	LTMUN		Ligji për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotura	
34	LVNM		Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis	
35	VKM		Vendim i Këshillit të Ministrave	
36	MIE		Ministria e Infrastruktures Energjitikës	
37	MTM		Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit	
38		NBO	Kërkesë biologjike për oksigjen	
39		NKO	Kërkesë e lartë kimike për oksigjen	
42	RKEAV		Ratifikimi i Kartës Evro.të Autonomisë Vendore	
43	SHGJSH		Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	
44	SKZHES		Strategjia Kombët. për Zhvillimin Ekon. dhe Social	
45	SMQV		Strukturat Mjedisore të Qeverisjes Vendore	
46		PPE	Toka, Ndërtesa, Makineri dhe Pajisje	
50	KTP		Kushtet Tenike te Projektit	
51	KTZ		Kushtet t Teknike te Zbatimit	
52	**2000/60/DU**	**2000/60/EC**	Direktiva Kuadër e BE-së për Ujërat	
53	**91/271/TUN**	**91/271/EEC**	Direktiva e BE-së Trajtimin e Ujërave të Ndotura	
54		ISO 14020	Standarti Eco - labeling	
55		ISO 14040	Standarti për Vlerësimin e Ciklit të Jetës	
56	PMKB	UNEP	Programi Mjedisor i Kombeve të Bashkuara	
59	Nj.A.U	L.A.U	Njesia Administrative Vendore	Local Administrativ Unit

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

ABSTRAKT

Rruga Unaze shtrihet ne nje terren te thyer ne qytetin e Prrenjasit

Kjo rruge do te rikonstruksohet dhe asfaltohet. Tereni eshte malor, dhe zona eshte e mbushur me ndertime mikse. Kjo rruge ju sherben banoreve dhe rrit mireqenien ekonomike dhe infrastrukturore te zones.

Konsulenti, (Vlerësuesi i Ndikimit në Mjedis), "Unitec Studio"shpk është kontraktuar nga "Porositësi" Bashkia Prrenjas për të realizuar Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për Parkut te Aventurave Pukë konform kërkesave të kontratës.

HYRJE

Vlerësimi i ndikimit në mjedis është procesi i identifikimit të pasojave të ardhshme të veprimeve të propozuara me qëllim garantimin se pasojat mjedisore janë marrë në konsideratë si duhet gjatë procesit të vendimmarrjes. Nëpërmjet identifikimit proaktiv të pasojave, vlerësimi i ndikimit mjedisor lehtëson vendimmarrjen e informuar bazuar në pranimin social të rreziqeve mjedisore të zhvillimit ekonomik. Qëllimi është shmangia e ndryshimeve mjedisore që do të përfundonin në rrjetën e dëmtimit të banorëve vendas dhe mjedisit të tyre.

Kur kryhen si duhet, këto vlerësime sigurojnë transparencë dhe përfshirje, përhapin vlerat demokratike, dhe rrisin pjesëmarrjen e komunitetit në zhvillimin e shoqërisë.Shoqata Ndërkombëtare për Vlerësimin e Ndikimit (IAIA) e përkufizon vlerësimin e ndikimit mjedisor (VNM)si **"procesi i identifikimit, parashikimit, vlerësimit dhe zbutjes së efekteve biofizike, sociale dhe efekteve të tjera të ngjashme të propozimeve për zhvillim para marrjes së vendimeve madhore dhe ndërmarrjes së angazhimeve**".

Megjithëse detajet e procedurave të VNM-së ndryshojnë nga njëri shtet në tjetrin, në varësi të kornizave të ndryshme rregullatore, procesi mund të ndahet përgjithësisht në tre faza kryesore:

a) Përcaktimi, nëse duhet të vlerësohen ndikimet e mundëshme në mjedis, duke pasur parasysh karakteristikat e një veprimi të planifikuar (p.sh. lloji, madhësia, vendndodhja), që ndonjëherë njihe edhe si shqyrtimi;
b) Përgatitja e vlerësimit gjithëpërfshirës të ndikimeve të mundshme në mjedis dhe e mënyrave se si ato mund të zbuten, rezultat i të cilës është studimi mjedisor;
c) Konsultimet publike për gjetjet e studimit dhe vendimmarrja përfundimtare. Studimi mjedisor është dokument kyç në zinxhirin e marrjes së lejeve.

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

OBJEKTIVI I VLERËSIMIT

Vlerësimi i Ndikimi në Mjedis për Rikonstruksion dhe asfaltim i rruges "Karriqi" Prrenjas Qarku Elbasan, është realizuar në bazë të matjeve dhe studimeve të kryera në terren nga grupi i punes ne baze te kontratës të lidhur me Bashkise Prrenjas, per te bere (Vlerësuesi i Ndikimi në Mjedis).

Në grupin e Vlerësimit të Ndikimi në Mjedis janë angazhuar Inxhinierë të profesioneve: Ambientalist Hidroteknik, Gjeodet, Gjeolog, Elektrik, Mekanik, ekspert në fushat e tyre, madhore e të përgjegjshëm para ligjit. Në këtë proces,vlen të përmendet dhe bashkëpunimi me administratën e Bashkise Prrenjas.

Vlerësimi është kryer në perputhje me kushtet dhe kërkesat e kontratës, Porositës – Konsulent,

Objektivi gjatë gjithë procesit të vlerësimit ka qenë:

a) Vlerësimi i Ndikimi në Mjedis i Parkut te Aventurave Pukë të jetë në perputhje me rekomandimet Europiane.

b) Vlerësimi të jetë në përputhje me kërksat e "Porositësit"Bashkia Prrenjas

c) Vlerësimi të jetë në përputhje me standartet Shqiptare dhe Europiane

KAPITULLI I INSTRUKSIONE

DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Vlerësimi i Ndikimi në Mjedis për Rikonstruksion dhe asfaltim i rruges "Unazë", ka filluar në datën 15.01.2021 dhe ka përfunduar në datën 20.01.2021

Dorëzimi i materialit të vlerësimit pranë Porositësit është bërë në datën 24.01.2021.

POROSITËSI

Porositesi i projektit me objekt: " Rikonstruksion dhe asfaltim i rruges "Unazë"" eshte Bashkia Prrenjas", Qarku. Elbasan

Adresa e Porositësit:

Rruga Skenderbeu , Bashkia Prrenjas

Tel: +355 (0)21222427

E-

mail: bashkiaprrenjas@yahoo.

com webb:

bashkiaPrrenjas.gov.al

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

QËLLIMI I RAPORTIT

Qëllimi i raportit është: Njohja dhe informimi për projektimin dhe konfigurimin e zhvillimit të propozuar, për të shmangur ndikimet negative, dhe për të identifikuar masat, duke përfshirë kompensimin për ndikimet e pashmangshme. Si rrjedhojë, të gjitha studimet mjedisore duhet të paraqesin këshilla të specializuara, gjithëpërfshirëse, dhe objektive, nëse ndikimi mjedisor i një zhvillimi të propozuar e realizuar është e një niveli të pranueshëm.

Të vlerësojë Ndikimin në Mjedis, të Projektit “Rikonstruksion dhe asfaltim i rruges “Unazë” konform kërkesave të porositësit “Bashkia Prrenjas”.

EMËRTIMI I PROJEKTIT TE IDEUAR

Emertimi i Projektit te ideuar eshte " Rikonstruksion dhe asfaltim i rruges “Unazë "

Shoqëria “Unitec - Studio.” i ka ofruar Bashkise Prrenjas projektin e n Rikonstruksion dhe asfaltim i rruges “Unazë” me kerkesen e kesaj te fundit. Qellimi i ketij projekti eshte te japi nje indicie zhvillimit te infrastruktures per bashkine e Prrenjas dhe me gjere

Objekti i projektit te propozuar është si më poshtë:

Hartimi i Projektit per “Rikonstruksion dhe asfaltim i rruges “Unazë”

DOKUMENTAT E MARRA NË KONSIDERATË NË VLERËSIM TË NDIKIMIT NË MJEDIS.

Ne daten 11.01.2021, konsulenti i ka drejtuar nje Leter-Kerkese. Bashkise Prrenjas, me anen e se ciles i kerkon te te depozitoje prane kompanis konsulente "Unitec Studio" shpk dokumentacionin e nevojshem ligjor dhe teknik qe disponon

Ne pergjigje te kerkese tone me date 15.01.2021, kemi marre nga Zyra e Urbanistikes se Bashkise Prrenjas dokumentacionin qe porositesi ka pare te arresyeshme per ti vere ne dispozicion te Konsulentit.

Nga Zyra e Urbanistikes se Bashkise Prrenjas, jane marre dhe administruar nga Projektuesi keto dokumenta te cilat do te jene pjese e kesaj dosjes nen emertimin

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

ANEKSE:

1. Projekt -Idene e "Rikonstruksion dhe asfaltim i rruges "Unazë" Prrenjas te hartuar nga specialiste të zyrës së Urbanistikës, Bashkia Prrenjas.
2. Ekstrakti tregetar dhe historik i Institucionit

SHENIM: Konsulenti i ka marre te mireqena gjithe te dhenat e dokumentacionit te mesiperm dhe ka seleksionuar informacionet ne rruge verbale duke i vleresuar ne objekt se ato jane te argumentuara.

METODAT DHE TEKNIKAT E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS .

Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, kosulenti ka ndjekur metodat dhe teknikat si më poshtë:

- Ka studiuar me detaje gjithë dokumentacionin ligjor e teknik të projektit.
- Ka vizituar me specialist të fushave të gjithavend - ndertimet dhe instalimet duke bërë matjet e vlerësimin e përmasimit dhe volumeve në vend.
- Janë marrë informacione verbale nga specialistët e bashkise Prrenjas
- Janë marrë informacione verbale dhe opinione nga komuniteti i zonës
- Është bërë rikonicioni i gjithe zones se shtrirjes se parkut , vend-ndërtimet dhe me gjere
- Është bërë vlerësimi i ndikimi mjedisor
- Janë formuluar rekomandimet për uljen e impaktit në mjedis gjate shfrytëzimit të PA-ve
- Përgatitja e vlerësimit gjithëpërfshirës të ndikimeve të mundshme në mjedis dhe e mënyrave se si ato mund të zbuten, rezultat i të cilës është studimi mjedisor;

Përqasja e konsulentit ndaj Vleresuesimi te Ndikimt ne Mjedis

Eksperti, eshtë angazhuar, per te qene sa me korrekt ne konstatimet dhe opinionin e tyre te pasqyruar në studimin mjedisor.

Konsulenti eshte udhehequr nga parimi:

"Një vlerësim mjedisor nuk mund të quhet i plotë, me të gjitha aspektet e rëndësishme të vlerësimit të ndikimit në mjedis, pa pjesemarrjen e gjerë ne vjeljen e opinioneve të pjesëtarëve te komuniteteve vendore të cilet lidhen dhe kane interesa direkt me këtë abitat natyror".

Në vleresimin e ndikimit në mjedis të "Rikonstruksion dhe asfaltim i rruges "Unazë" , konsulenti është bazuar në 'Udhëzimin e Komisionit Evropian për Rishikimin e VNM-së: EIS-së' të qershorit të vitit 2001.

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

Eksperti mbasi ka vjelë opinione nga një pjesë e komunitetit, në shërbim të realizimit të objektivit, ka konstatatuar dhe ka dhënë opinioni e tij për të përmirësuar parametrat mjedisore, me qëllim për ta prure projektin ne paramete optimale ndaj mjedisit

Përmbajtja e këtyre kapitujeve është pasqyruar nga një sërë pyetjesh për të cilat janë dhene përgjigje te permbledhura.ne formën si më poshtë:

- **Nuk ka.**
- **I përmbush plotësisht praktikat e mira.**
- **I përmbush pjesërisht praktikat e mira**
- **Nuk i përmbush praktikat e mira.**

Keto pvrgjigje duhet lexuar dhe kuptuar si me poshtë:

- **Nuk ka.**

Kjo përgjigje është e përshtatshme, në rastet kur pyetjet janë specifike për një lloj zhvillimi ose teknologjie, që nuk është çështje e studimit mjedisor në vlerësim. Për shembull, nëse përgatitet një studim mjedisor për ndërtimin e një Parku argetimi brenda kufijve të një parku kombëtar, përgjigjja për pyetjet që lidhen me mbetjet bërthamore do të ishte 'nuk ka'.

- **I përmbush plotësisht praktikat e mira.**

Kjo përgjigje jepet ndaj pyetjes përkatëse, kur konstatimet dhe vete studimi, përmbushin kerkesat ambientale ne shkallen me te lartë dhe projekti nuk ka nevoja per permiresime te metejshme.

Të dhëna dhe informacione të tilla duhet të jenë të përditësuara, gjithëpërfshirëse dhe të lidhura me objektin e vleresimit;.

Për shembull, nëse përgatitet një studim mjedisor për ndërtimin e një Parku argetues brenda kufijve të një parku kombëtar, vlerësuesit duhet të tregojnë se pyetjet që lidhen me ndikimin e tij në biodiversitet i **përmbushin plotësisht praktikat e mira**.

- **I përmbush pjesërisht praktikat e mira.**

Kjo përgjigje tregon se parametrat mjedisore te objektit apo studimi mjedisor nuk ofron nuk permbushin plotesisht standartet. Për shembull, nëse përgatitet një studim mjedisor për ndërtimin e një Parku argetues brenda kufijve të një parku kombëtar, nëse

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

informacioni që do të jepet si përgjigje ndaj pyetjeve lidhur me ndikimin në biodiversitet i referohet vetëm ekzistencës së zonës së mbrojtur pa marrë parasysh ndikimet, këto pyetje do të vlerësohen si **'i përmbushin pjesërisht praktikat e mira'.**

- **Nuk i përmbush praktikat e mira.**

Kjo përgjigje tregon një devijim të ndjeshëm nga zbatimi i projektit dhe qëllimi i studimit mjedisor, duke ngritur shqetësime serioze për cilësinë e vendimit që mund të merret bazuar në informacionin e paraqitur në studim.

Për shembull, nëse përgatitet një studim mjedisor për ndërtimin e një Parku argetues brenda kufijve të një parku kombëtar, dhe informacioni në studim që do të përdoret si përgjigje ndaj pyetjeve lidhur me ndikimin në biodiversitet nuk përmend madje as ekzistencën e zonës së mbrojtur, këto pyetje do të vlerësohen si **'nuk i përmbushin praktikat e mira'.**

Në vlerësimin e ndikimit në mjedis, konsulenti duhet:

Para realizimit të studimit mjedisor, vlerësuesit janë njohur me listën e kontrollit me qëllim që të kuptojnë llojin e informacionit që duhet të kërkojnë.

Gjatë realizimit të studimit mjedisor, konsulenti përgjigjet për secilën pyetje, duke përdorur përshkruesit cilësorë të përmendur më sipër.

Rëndësi te veçante, krahas mundësimit të vlerësimit kritik të studimit, i kemi dhënë identifikimit dhe pasqyrimit të shembujve pozitivë dhe praktikave të mira.

KONFIRMIMI I EKZAMINIMIT FIZIK TË OBJEKTIT

Për të marrë njohuri me të sakta rreth detyrës që ka marrë nga porositësi, vlerësuesi me grup pune i perbërë nga specialistë të fushës , në datën 14.01.2021, ka vizituar objektin. Në vazhdim specialistët dhe vlerësuesi kanë verifikuar, kontrolluar e vlerësuar projektin e propozuar dhe gjithë nën/objektet e tij ne drejtim te ndikimit ne mjedis.

Per gjithë nën objektet e veprës argetuese janë bërë gjithë vrojtimet e matjet,vleresimet e nevojshme për të parë në se i përmbushin parametrat mjedisore.

BAZAT LIGJORE TË VLERËSIMIT (LIGJET DHE UDHËZIMET).

Shërbimi konsulencës (vlerësimit) do të kryhet konform ligjeve dhe akteve nën/ligjore si më poshtë:

- Ligji Nr.9663, datë 18.12.2006 i ndryshuar "Për koncesionet".

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

- Ligji Nr.9072, datë 22.05.2003, i ndryshuar "Për sektorin e Energjisë Elektrike".
- Ligji nr. 8990, datë. 23.01.2003 "Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis"
- Ligji Nr.8093, datë 21.03.1996 "Për rezervat ujore".
- Ligjit Nr.10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit"
- Ligji Nr.9385, datë 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor".
- Ligji Nr. 8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit".
- Ligji Nr.183, datë 28.04.2005 "Për Vlerësimin e Tokes"
- Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregëtare"
- Ligj nr.8402, datë 10.9.1998 Për kontrollin dhe disiplinimin e pun. të ndërtimit ndryshuar me:
- - ligjin nr.9200, datë 26.2.2004
- - ligjin nr.9794, datë 23.7.2007
- - ligjin nr.9826, datë 1.11.2007
- - ligjin nr.10324,datë 23.9.2010
- Ligjit Nr.9779, datë 16.07.2007 "Per sigurinë e pergjitheshme"
- Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010 "Mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Punë"
- Ligji Nr. 11/12, date 15.12.2012Per Menaxhimin e Integruar Te Burimeve Ujore.
- V.K.M Nr.103,datë 31.03.2003 "Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë
- VKM Nr.529, datë 08.06.2011 "Për caktimin e kritereve, të proçedurës dhe të ënyrës së dhënies me qera, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore (i ndryshuar).
- Udhezimi Nr. 1, datë 19.2.2018 "Për miratimin e kërkesave minimale për zhurmat"

KAPITULLI 2 TË DHËNAT E OBJEKTIT

ADRESA DHE VEND-NDODHJA E OBJEKTIT

"Rikonstruksion dhe asfaltim i rruges "Karriqi" do të ndërtohet në rrethinat e qytetit të Prrenjass qarku Elbasan.

TË DHËNAT GJEOGRAFIKE, HIDROLOGJIKE,GJEOLOGJIKE E SOCIALE TË ZONËS

Gjeografia

Bashkia Prrenjas është formuar në vitin 2015. Bashkia e Prrenjasit pozicionohet në lindje të Shqipërise dhe bën pjesë në Qarkun e Elbasanit. Bashkia Prrenjas kufizohet

Në Veri dhe veri lindje me bashkine Librazhd

Në Lindje me Republikën e Maqedonisë së Veriut

Në Jug me bashkinë Pogradec

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

Në Jug perëndim me Bashkinë Elbasan dhe Gramsh.

Kryeqëndra e Bashkise është qyteti i Prrenjasit me sipërfaqe 18.3 km^2
Zona e propozuar për "Rikonstruksion dhe asfaltim i rruges "Unazë" Prrenjas, ndodhet pranë zones Industriale. Kordinatat gjeografike janë me system KRRGJ. Koordinatat e fillimit te rruges : 545679.960 ; 4548184.120 dhe koordinatat e perfundimit te rruges : 545889.688 ; 4548842.145

Topografia

Nga pikpamja gjeografike, Bashkia Prrenjas shtrihet në Krahinën Malore Qëndrore, në pjesën jugore të saj, në Fushëgropën e Prrenjasit. Kjo Fushëgropë shtrihet midis malit të Shebenikut në very dhe malësisë së Mokrës në jug. Në lindje shkon deri në rrëzë të Qafës së Thanës dhe kurrizit të Muçalit, ndërsa në perëndim kurrizi i ulët e kodrinor i Rashtanit e ndan nga lugina e Shkumbinit të Sipërm. Brenda këtyre kufijve fushëgropa ka gjatësi lindje – perëndim deri rreth 7 km, gjerësi deri 5 km. Ajo përbehet nga tri fusha kryesore, fusha e Domosdovës, e Rrajcës dhe ajo e Katjelit. Dy të parat ndodhen në të njëjtin nivel, ndërsa e treat ndodhet rreth 20 m më lart dhe ndahet prëj tyre nga një kurriz i ulët kodrinor me lartësi relative deri në 100m. Majat më të larta të zonës janë ajo e Reshpës me kuotë 2262 mnd, maja e Shebenikut me kuotë 2251 mnd, maja e Fursit me kuotë 2194 mnd, maja e Dupkës me kuotë 2137 mnd, maja e Buturakut me kuotë 2050 mnd dhe kuota më e ulët është ajo e përroit të Peshkut 2029 mnd

Relievi

Zona ku ndodhet rruga në një terren jo shume thyer malor me pjerrësi që arrin deri ne (15-20)%.

Gjeomorfologjia

Forma e tokës në këtë zonë me përjashtim të shtratit te liqenit ka një cikël të gjatë ndryshimi Edhe pse terreni është i pjerrët, në ditë me rreshje shirash me intesitet të lart apo në periudhën e shkrirjes së borës ka perrenj të rrëmbyeshëm duke te cilet perbejne rrezik per erozionin dhe rreshqitjen e dherave e për rrjedhoje duke ndryshuar formën e tokës në këtë seksion.

Cilësia e ajërit dhe e zhurmave

Cilesia e ajrit është e lidhur drejtpërsëdrejti me shëndetin e njerëzve. Indikatorët e cilësisë së ajrit janë grimcat e pluhurit (PM) që janë përzierje aerosolesh të ngurta dhe /ose të lëngta që

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

përfshijnë një diapason të gjerë në grimca dhe përbërje kimike, por praktikisht vlerësohen PM10 dhe PM 2.5 që emetohen direct si grimca primare ose formohen nga emetimet e SO_2, NOX, NH_3, NMVOX. Bashkia në tërësinë e konfiguracionit të saj karakterizohet nga parametra optimal të ajrit. Kjo është e lidhur me gjeografinë, relieving, klimën, biodiversitetin dhe impakti i ardhur nga veprimtaria jo efiçente e minierave aktuale në shfrytëzim. Kryeqëndra e bashkisë ku është përqëndruar aktiviteti më i lartë social ekonomik por dhe pozicionimi në grabenën e kodrave rrethuese tregon një cilësi të ajrit në përkeqësim. Shqetësim për cilësinë e ajrit përbëjnë dhe përdorimi i mjeteve motorike të amorituzara që emetojnë sasira të konsiderueshme gazesh. Më problematike është zona e aksit nacional që përshkon qytetin e Prrenjasit ku tejkalohet numri i ditëve sipas standartit ditor të BE (50 $\mu g/m^3$) dhe ku numri i ditëve të lejuara është 35. Të lidhur me faktorët e sipërcituar jo shumë e mirë në zonat urbane është dhe gjendja e NO_2, SO_2, O_3, CO dhe BTEX. Por kryesisht ndotës të ajrit me këto kompnente apo element janë makinat, zjarret, djegia e biomasave, djegia e mbeturinave në vend depozitime hapsinore apo kazanet e grumbullimit. Vlerësohet se si ndotës real për tu vlerësuar dhe konsideruar problematic janë PM10, PM 2.5 dhe SO_2 të lidhura me burimet gjeneruese dhe mungesën e masave alternative sikurse është pastërtia dhe gjelbërimi i pakët në pikat e cituara.

Zhurmat / akustika

Efektet e zhurmave pasqyrohen në sjellje dhe shëndetin human por dhe më gjerë të mjedist biologjik. Ndotja akustike shkaton dëmtime fiziologjike, akustike, agresivitet, stress, shqetësimi, gjumi, humbje dëgjimi, ndryshim sjellje riprodhuese apo ushqyese në faunë. Shqetësim burimi i zhurmave përbën për qëndrën e bashkisë ku gjenerohen nga industria ndërtimore, sistemi i transportit, gjendja e mjeteve motorike, lokalet etj. Ndërkohë që një burim real sidomos për biodiversistetin dhe korridoret biologjike është aksi i korridorit 8, që gjeneron zhurma të ndjeshme. Problemi bëhet i ndjeshëm për faktin e prezencës së zhurmave në intervalin ditë/natë dhe tejkalimi i kufirt të BE (55/45 dB).

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'



Fig Nr. 1 Harta e resurseve ujore e Shqipëri

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

Kushtet gjeologjike dhe hidrogjeologjike të zonës Të dhëna hidrogjeologjike:

Pasuri ujore (Hidrografia) Burimet hidrike të zonës janë mjaft të pasura dhe të larmishme në formë. Burimi kryesor është rrjedhja e sipërme e shtratit të lumit Shkumbin që formon dhe grabenen më tipike të zonës. Së dyti ka mjaft burime ujore statike, pra liqenore (natyrore dhe artificiale) ku padyshim më të rëndësishme janë ato të liqeneve të Rrajcës, por edhe rezervuarët e krijuar krijojnë mjedis me impakt pozitiv mjedisor. Ujrat karakterizohen nga parametra fiziko – kimik dhe organoleptik të përshtatshëm për pirje por dhe për shfrytëzim në ekonomitë e njësive të vlerësuara sipas origjinës së tyre. Në zonën e zbatimit të këtij projekti nuk ka burime ujore të identifikuara në afërsi. Projekti i rikonstruskionit dhe asfaltimit të rrugës ndodhet në Qarkun Elbasan, Bashkia Prrenjas, rruga 'Unazë' dhe nuk ndodhet në brendësi apo në afërsi të burimeve ujore të rëndësishme si Lumenjtë kryesore, Liqene, Rezervuar apo Zona Bregdetare. Në afërsi të zonës ndodhet vetëm Rezervuari i Prrenjasit i cili ndodhen në një largësi të konsiderueshme nga zona ku do të kryhen punimet e rikonstruksionit të rrugës. Burime ujorë të afërt jane Lumi i Shkumbinit, i cili ndodhet në jug – perëndim në largësi 5.7 km në vijë ajrore. Rezervuari i ujëmbledhës i Prrenjasti ndodhet pothuajse në jug të segmentit rrugor rreth 1.36 km.

Cilesia e lumenjve

Monitorimi i cilësisë së ujit është i rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e ujrave, identifikimin e shkaktarëve të ndotjes deri në dhënien e rekomandimeve përkatëse sipas porblematikave të identifikuara. Ky program monitorimi me një frekuecnë 4 herë/vit siguron një bazë të dhënash, të cilat përdoren në hartimin e Raporteve të Gjëndjes së Mjedisit, në hartimin e informacioneve në nivele lokal, kombëtar e ndërkombëtar, si dhe raportimet në Agjencinë Europiane të Mjedist.

Gjendja e treguesve mjedisor, ndikimi në mjedis dhe tendenca

Rrjeti i monitorimit është i shtrirë në lumenj, liqene, zona bregdetare dhe stacione pranë impianteve të trajtimit të ujrave të zeza. Bazuar në Urdhërin e Brendhsëm me datë 13.06.2017 me Nr. Prot 1464 mbi riorganizimin e proçesit të monitorimit të cilësisë së ujrave sipërfaqësore, cilësine e ajrit urban dhe monitorimin e zhurmave, i cili u pezullua më datë 22.05.2017 për shkak të mungesës së financimit për të realizuar monitorimet e programuara. Vlerësimi paraprak i cilësisë së lumenjve dhe liqeneve përcaktohet në bazë të parametrave fiziko – kimikë duke i krahasuar me normat e lejuara të përcaktuara në Direktivën Kuadër të Ujit të BE. Për klasifikimin e zonave bregdetare dhe stacionet pranë impianteve të trajtimit të ujrave të zeza i referohemi VKM 177 dt 31.03.2005, Norma e

Besmira Nike
Digitally signed by Besmira Nike
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

lejuara të shkarkimeve urbane nga impiantete e trajtimit.

Parametrat e analizuar në laborator

Sipas analizave të vlerësimit të gjëndjes së trupit ujor, kryesosht të lumit Shkumbin që përfaqëson arterien më të rëndësishme por edhe fluentin ujëmbledhës të pothuajse tërësisë hapsinorë të bashkisë rezulton se gjendja paraqitet si më poshte (pika e monituruar është në Qukës) :

- Përmbajtja e oksigjenit të tretur 9.5 mg/l pra e cilësisë së mirë (norma > 7)
- Përmbajtja e lëndëve organike e shprehur në nevoja biologjike për oksigjen ose NBO_5 , është shumë e ulët dhe klasifikohet e cilësisë së dytë.
- Përmbajtja e nevojës kimike për oksigjen NKO që është tregues i ndotjes kimike dhe organike është 4.36 mg/l
- Përmbajtja e fosforit total është 0.056 mg/l duke qenë vlerë në normë dhe ujrat konsiderohen të cilësisë së mirë
- Përmbajtja e nitriteve është 0.004 mg/l ora ujë i cilësisë shumë të mirë
- Përmbajtja e NH_4 (amoniakut) është 0.067 pra uji i cilësisë së dytë, gjendje e mirë
- Përmbajtja e nitrateve NO_3, vlerësohet i cilësisë shumë të mirë nën normën e lejuar < 0.8 mg/l

Duke marrë pikën monitoruese si pikë fundore të bashkisë lumi Shkumbin në këtë segment konsiderohet i cilësisë së dytë. Ndërsa të gjitha burimet ujore të mësipërme vlerësohen të cilësisë së parë, pra shumë të mirë. Ujrat nëntokësore janë më të ekspozuara potencialisht ndaj ndotësve për shkak të struktures gjeologjike, aftësisë infiltruese, mungesës së shtresës ekranizuese, shkarkimeve urbane, bujqësore dhe blegoriale të pakontrolluara por dhe të vendodhjes së aktiviteteve impaktuese pa studime hidrogjeologjike paraprake. Sipas analizave të elementëve kimik dhe anioneve e kationeve vlerësuese ujrat nëntokësore të zonës konsiderohen shumë të mirë.

Gjeologjia

Sipas studimit Gjeologjia - Gjeoresurset – Gjeorreziqet për Bashkia Prrenjas nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar, formacionet hidrogjeologjike janë përshkruar në vijim.

Depozitimet e Triasikut të sipërm – Jurasikut të poshtëm ($T_3 – J_1$).

Gëlqerorët platformike të Triasikut të sipërm – Jurasikut të poshtëm kanë përhapje tepër të gjërë në zonën e Rrajcës, pjesa lindore e masivit të Shebenikut si dhe në pjesën perëndimore të cilat

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

takohen në trajtë pullash

Shkëmbinjtë ultrabazike

Përfaqësojnë pjesën qëndrore të masivit ultrabazik të Shebenikut dhe kanë përhapje të konsiderueshme në rajon. Duke filluar nga poshtë – lart në ndërtimin gjeologjik marrin pjesë këto formacione :

Depozitimet e Kretakut të Sipërm (Cr_2)

Këto depozitime dalin në sipërfaqe pa ndërprejre që nga vendburimi i Pishkashit deri tek maja e Skroskës, mandej ndërpriten dhe shfaqen në formë blloqesh deri në vendburimin e Bushtricës duke përfshirë edhe Bushtricën e sipërme

Depozitimet e Paleogjenit e Neogjenit

Kanë përhapje shumë të madhe dhe zënë pjesën perëndimore dhe juglindore të rajonit. Dallohen depozitimet e Oligocenit, Akujtanian – Burdigalianit dhe Helvecianit

Depozitimet e Oligocenit

Dalin në formë rripi të ngushtë nga fshati Pishkash deri në Skroskë ku vendosen transgresivisht mbi gëlqerorë me rudiste të katit Santonian, ndërsa në very kontaktojnë tektonikisht mbi shkëmbinjtë ultrabazike

Depozitimet e Akujtanian – Burdigalianit

Duken në sipërfaqe në fshatrat Pishkash e Skorksë si dhe në vendurimin e Bushtricës. Përfaqësohen nga conglomerate me ndërthurje në formë thjerrëzash. Vendosen transgresivisht mbi formimet e Oligocenit

Depozitimet e Kuatenare

Zënë pjesë të ulta të relievit dhe faqet e maleve. Gjate lumit të Bushtricës takohen aluvionet të përfaqësuara nga zaje ultrabazikësh, gëlqerorësh e ranorësh të pa çimentuar. Në të dy anët e lumit vihen re tarraca të vogla lumore me trashësi deri 30 m

Depozitimet liqenore e kënetore

Kanë përbërje kryesisht homogjene e përbëhen nga argjila. Mbulojnë fushën e Domosdovës dhe pjesërisht fushen e Rrajcës, Trashësia e këtyre depozitimeve luhatet nga disa metra deri në mbi 20 – 30 m

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

Depozitimet aluviale - proluviale

Janë të përfaqësuara nga masa alevrolito – ranore me zhavore me përbërje rërash, surërash, suargjilash. Aluvionet janë formuar në kushtët e depozitimeve të përrenjëve si rezultat dhe shtresëzimi i përgjigjet kushteve të formimit. Këto depozitime kanë trashësi të ndryshme, trashësia maksimale e tyre arrin deri 1-3 m

Depozitimet deluviale

Kanë përhapje të konsiderueshme. Këto depozitime mbulojne gjithë fushën e Rrajcës si dhe takohen në pjesët më të ulta të shpateve kodrinore dhe në luginat e përrenjëve dhe të lumenjve




Fig.3 Harta gjeologjike e zones

Tektonika

Në rajon është e zhvilluar tektonika diznjuktive e karakterizuar kryesisht nga faljet dhe mbihipjet. Tektonika rrudhosëse nuk vërehet. Më e theksuar është tektonika në formë faljesh e cila ka ulur blloqet e depozitimeve të Kretakut të Sipërm e të Neogjenit, me aplitude 1 – 10 deri 100 – 150 m

Kushtet gjeologo-inxhinierike të zonës

- Rajoni i studiuar sipas përbërjes litologjike ndahet në
- Shkëmbinjtë magmatikë
- Shkëmbinjtë ultrabazike (dunite, harcburgite, lercolite)
- Konglobrekçiet ofiolitike (ultra bazike, vullkanike, gëlqerore
- Shkëmbinjtë mollasike : conglomerate, ranore, alevrolite
- Depozitimet e shkrifta (Dherat)
    - Dherat me kohezion – Suargjilat, argjilat
    - Dherat pa kohezion – rërat, zhavoret

Klasifikimi gjeoteknik i shkëmbinjve

Për klasifikimin gjeoteknik të shkëmbinjëve si kritere kryesore janë marrë përbërja litologjike e shkëmbinjëve dhe vetitë fiziko – mekanike të tyre. Në bazë të këtyre treguesëve është bërë bashkimi i grupeve të shkëmbinjëve të analizuar në paragrafin e mësipërm në zona, sipas të cilave rajoni i studiuar ndahet në

Zona e shkëmbinjëve të fortë

- Zona e shkëmbinjëve mesatarisht të fortë
- Zona e shkëmbinjëve të shkrifët

Fenomenet Gjeodinamike

Nga proçeset gjeodinamike që janë present në zonën e studiuar përmendim

- Erozionin
- Rrëshqitjet
- Sizmicitetin

Duke përmbledhur, mund të themi se :

Zona e qytetit Prrenjas dhe periferia rreth tij, kryesisht përbën një reliev kodrinor, pak a shumë të rrafshët deri malor në periferi. Ndërtimi gjeologo – litologjk është i larmishëm ku prëdominojnë mbulesa – suargjilat, zallishtet, depozitimet konglomeratike (suita e kuqrremtë e Prrenjasit) dhe shkëmbinjtë magmatike. Zona urbane e qytetit Prrenjas, përgjithësisht është një zonë e përshtatshme për ndërtime. Por, pavarësisht kësaj, është e domosdoshme që çdo ndërtim duhet të shoqërohet me studim gjeologo – inxhinierik. Treguesit fiziko – mekanik janë orientuese pasi një

Besmira Nike
Digitally signed by Besmira Nike
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

pjesë e tyre, sipas klasifikimit gjeoteknik të shkëmbinjëve, janë teorik të kombinuara me ato të marra nga studimet e kryera në këtë bashki për ndërtime të tjera të kryera më parë.

Sizmiciteti i Zonës

Prrenjasi ndodhet në afërsi të thyerjes tektonike regjionale gjatësore jug - veri , Bilisht – Mokër-Mat dhe asah tërthore lindje - perëndim, Lushnjë – Elbasan – Dibër. Si e tillë kjo zonë është goditur herë pas here nga tërmete të fuqishme. Sipas rajonizimit sizmik të Shqipërise, qyteti i Prrenjasit futet në zonën me intesitet tërmetesh 7-8 ballë, kjo duhet vlerësuar vazhdmisht nga projektuesit e ndërtuesit.

.Qyteti i Prrenjasit dhe zona përreth tij, ndodhet në brezin e fuqishëm sizmik Peshkopi – Korçë me shtrirje veri-jug. Nga ky brez sizmo-aktiv edhe në ditët e sotme, sipas hartës së tërmeteve maksimal të pritshëm, janë gjeneruar tërmete me magnitudë maksimale të pritshme Mmax = 6.5-7.0

Qyteti i Prrenjasit dhe zona përreth tij është prekur nga disa tërmete të fuqishëm që kanë patur vatrat e tyre në brezin sizmologjik Elbasan – Dibër.(tërmetet që kanë ndodhur në rajonin Dibër-Çermenikë-Prrenjas) dhe brezin sizmologjik Peshkopi – Korçë (tërmetet që kanë ndodhur në rajonin Korçë- Pogradec – Mokër) dhe që kanë shkaktuar dëme edhe në hapësirën përreth qytetit të Prrenjasit. Sipas hartës së rajonizimit sizmik të vendit, Prrenjasi përfshihet në një zonë ku brenda 100 viteve të ardhshëm mund të priten tërmete me intesitet max = 8 balle MKS-64 për kushte mesatare trualli.

Klasifikimi i trojeve për vlerësimin e rrezikut sizmik që përdoret në Kodin Shqiptar të Projektimit KTP – N2- 89 aktualisht në fuqi është bazuar në studimin për rajonizimin sizmik të vendit ku është dhënë për herë të parë koncepti i konditave mesatare të trojeve.

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'




Fig.4. Harta sizmike e Shqiperise

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

A) PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI, SHOQËRUAR DHE ME FOTOGRAFI;

TË DHËNAT MBI EKOSISTEMIN "FLORËN DHE FAUNËN" E ZONËS

Projekti objekt i këtij raporti të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis ndodhet në Qarkun Elbasan, Bashkia Prrenjas, rruga “Unazë”. Projekti i propozuar dhe punimet konsistojnë në rikonstruksionin dhe asfaltimin e rrugës “Unazë”. Ndërhyrja në këtë zonë me përmirësim të infrastrukturës rrugore synon në një përqasje të integruar të zhvillimit ekonomik, përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe mbrojtjes së ambientit. Rruga “Unazë” ka infrastrukturë të dëmtuar ekzistuese ndërkohë në disa segmente ka mungesë të shtresave rrugore dhe trotuarëve. Ky bllok në të cilën shtrihet rruga karakterizohet nga ndërtime miks të realizuara në periudha të ndryshme kohore, por kryesisht në sipërfaqen më të madhe të tij me ndërtime të realizuara pas viteve 1990, me lartësi 1 – 3 kate.

Në zonën ku do të kryhen punimet u identifikuan fidane pemësh të llojit shkurre, pemë frutore. Në një inspektim në terren përgjatë segmentit rrugor që do te rikonstruktohet u konstatuan shkurre te moshes 10 vjeçare, pemë frutore 5-10 vjeçare. Këto pemë të identifikuara në terren janë mbjellë vitë me parë dhe do të preken nga punimet e rikonstruksionit. Projekti i rikonstruksionit ka parashikuar mbjelljen e fidaneve të rinj dekorative përgjatë rrugës në të dyja krahët e trotuarëve.

Në këtë projekt nuk këmi vlerësim të sipërfaqes bimore pasi rikostruksioni i rrugës nuk prek hapësira të gjelbra të zonës. Pothuajse në të gjithë zonat periferike dhe qëndrore të qytetit të Prrenjasit vërehet një mungesë e theksuar e hapësirave të gjelbërta dhe parqeve publike. Kryesisht gjelbërimi është i përqëndruar përgjatë segmenteve rrugore në pjesën e trotuarëve dhe në qëndër te qytetit.

Biodiversiteti dhe habitatet (të përgjithshme)

Biodiversiteti

Shqipëria vlerësohet për një larmi të madhe biologjike dhe peisazhore. Origjina të kësaj llojshmërie është e lidhur me : Pozicioni gjeografik, faktorët gjeologjike, pedologjikë, hidrologjikë, relievi dhe klima. Larmia e madhe e ekosistemeve dhe habitateve (ekosistemeve detare, bregdetare, laguna e vende të lagëta, delta lumenjsh, duna ranore, liqene, lumenj, shkurreta mesdhetare, pyje gjethgjërë, halorë dhe të përzier, livadhe dhe kullota subalpine e alpine, ekosisteme të maleve të lartë) ofron një larmi të pasur llojesh bimore dhe shtazire duke përfaqësuar rreth 30 % të florës Europiane. Në përcaktimin ligjor kemi ketë përcaktim :

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

“Biodiversitet (shumëllojshmëria biologjike) ose larmi biologjike” është tërësia e organizmave të gjallë të të gjitha llojeve, duke përfshirë, ndër të tjera, ekosistemet tokësore, detare dhe ekosistemet e tjera ujore, si dhe komplekset ekologjike, ku ato bëjne pjesë. Vizioni ynë për biodiversistetin është : të sigurohet zhvillim normal i florës dhe faunës në vendjetesat e tyre, që këto peisazhe jo vetëm të zbukurojnë natyrën por dhe te kontribojnë në rritjen në begatinë e vendit e mirëqenien e popullit. Me më shumë se 3200 lloje të bimëve vaskulare dhe 756 specie vertebrore dhe me rreth 30% të të gjithë florës europiane që zhvillohet në Shqipëri, me të drejtë mund të ndihemi krenar për natyrën tonë. Por, ndërsa koncepti i biodiversitetit ka përcaktim global, ruajtja është thjesht një aktivitet lokal. Sa i takon ruajtjes të gjithë duhet të ndihemi fajtor për humbjet në biodiversistet. Shqipëria si një vend që synon të anëtarësohet në BE ka përgjegjësinë për të ndërmarrë veprime konkrete për të mbrojtur Biodiversitetin e saj, duke qenë se humbja e këtij thesari me të gjithë ekosistemet krijon efekte negative në ekonimi duke rrezikuar një një farë mënyre atë. Për të ndalur humbjen e biodiversitetin e saj, duke qenë se humbja e këtij thesaro me të gjithë ekosistemet, krijon efekte negative në ekonomi duke rrezikuar në një farë mënyre atë. Për të ndaluar humbjen e biodiversitetit në Shqipëri, duhet të ketë një sipërmarrje të përbashkët “ Biodiversiteti është ekzistenca jonë, është eksiztenca juaj është me rëndësi përfshirja e komunitetit, në mënyrë që të ruhet kjo pasuri që në fund na bën të ndihemi kaq shumë krenarë”. Përpjekjet për të mbrojtur tokat natyrore dhe ujërat tona duhet të jenë fokusi i interesit dhe veprimtarisë së të gjithaëve dhe vlerësimi i statursit të ruajtjes së llojeve të veçantë është çelësi për të kuptuar gjendjen e përgjithshmë të florës dhe faunës dhe vendosjen e prioriteteve për ruajtjen”. Humbja e biodiversitetit si problem global, përbën aktualisht një ndër problemet më të mëdha në botë. Ekspertet japin alarmin duke konkluduar : se nëse do të vazhdohet me këtë trend, humbja e biodiversitetit do të ketë pasoja fatale për njerëzimin. Vlerësimet e fundit shkencore parashikojnë se, me ritmet e sotme të shpyllëzimeve, brenda 25 – 30 viteve të ardhshëm do të zhduken deri në 10 % të llojeve të njohura në planet. Pasojat e kësaj humbje do të reflektohet edhe në ekonominë botërore dhe në zhvillimet shoqërore në përgjithësi, duke pasur parasysh faktin se afro 40% e ekonomisë botërore dhe 80 % e nevojave të njeriut plotësohen nga resurset biologjike. Ruajtjae biodiversitetit është e rëndësishme dhe e domosdoshme për shumë arsye, por në këtë rast do të përmendim vetëm disa prej tyre : Ruajtja e biodiversitetit është detyrim i yni moralqë tiu lemë pasardhësve një mjedis po aq të pasur sa kemi trashëguar nga paraardhësit tanë. Çdo qenie e gjallë ka të drejtë të jetojë, ashtu si dhe vetë njeriu : qeniet e gjalla që kanë jetuar dhe evoluar në mijëra milionë vjet mund të zhduken shumë shpejt, por nuk mund të krijohen përsëri. Mjedisi ndotet në toke ujë dhe ajër. Ky është një problem i madh i kohës sonë. Kështu përgjegjësit kryesor të ndotjes së ujrave të

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

detit janë shkarkimet urbane, industriale, bujqësore të zonave më të zhvilluara, si dhe shkarkimet e naftës në zonat ku ajo nxirret. Edhe zonat e bregdeteve dhe ishujt rrezikohen nga ngohja e klimës : shkrirja e një pjese të akullnajave çon në rritjen e nivelit të detit. Ndotja e ajrit dëmton jetën e njeriut, dëmton sytë, rrugët e frymëmarrjes. Sot në shumë vende ka agjenci që matin shkallën e ndotjes së ajrit dhe kur kjo është e lartë marrin masa si mbyllja e fabrikave, ndalojnë qarkullimin e makinave etj. Disa qytete të Shqipërise, sidomos Tirana dhe Elbasani janë shumë të ndotur. Era e rëndë, thithja e ajrit të ndotur janë disa nga problemet e përditshme me të cilat përballen qytetet, ku trafiku i automjeteve, shkarkimet industriale dhe ngrohja e banesave janë të përqëndruara në zona të ngushta : kush banon në qytet e ndjen menjëherë problemin e ndotjes së mjedisit. Mbetjet urbane përmbajnë edhe produkte kimike që zbresin në thellësi dhe ndotin burimet e nëndheshme ujore. Në qytete, ndodhen gjithashtu edhe kantierët e ndërtimit, që shpesh derdhin nëpër lumenj sasi të mëdha materiali ndërtim. Zhvillimi i turizmit ka ndikime direkte në biodiversitet. Tashmë vendi ynë është kthyher në një destinacion të njohur i orientuar tek ekoturizmi. Për fatkeq hapësira bregdetare ka qënë pre e shkaterrimëve që kanë rrjedhur nga perdorimi turistik i këtij rajoni. Pasojat më të mëdha të këtyre shkatërrimeve kanë të bëjnë me mbingarkesat ndërtimore të natyrës dhe të peisazhit. Të gjitha këto probleme konfliktuale që lindin midis turizimit dhe biodiversitetit në zonën bregdetare është shumë e rëndësishme të parandalojnë në zonën malore dhe në peisazhet pyjore ekzistuese.

Gjenda e disa specieve aromatiko – mjekësore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukje.

Nëpërmjet një sistemi monitorimi do të arrihet vlerësimi i gjëndjes së disa specieve aromatiko – mjekësore të cilat janë në rrezik zhdukje si dhe përshkrimi i gjëndjes së Sherebelës në rajonin qëndror të vendit tonë, do të na japin të dhëna të plota, për bimët aromatiko – mjekësore. Me anë të këtij studimi synohet : Së pari, të identifikohen faktorët kryesore sociale, ekonomike dhe politike që kanë çuar drejt pakësimit, Së dyti, duke përdorur një analizë social – ekonomike, duke vlerësuar rëdnësinë sociale dhe ekonomike për mbledhësit e këtyre prodhimeve. Së treti, te ofrojmë rekomandime për mbarështimin në mënyrë të qëndrusehme dhe për të rritur të ardhurat e popullatës. Menaxhimi dhe zhvillimi i aktivitetit të prodhimit të specieve aromatiko – mjekësore mundet të jetë një alternativë për rritjen e nivelit të të ardhurave plotësuese në zonat rurale, të tilla si :

- Kapacitet i kufizuar i aftesive prodhuese
- Fragment i theksuar i tokës në mesatarisht 3 – 4 ngastra për fermë
- Vështirësi të shumta financiare për sigurimin e mjeteve të nevojshme të prodhimit
- Mundesi të pakta për sigurimin e kredive
- Mungesa e një shërbimi ekstensioni

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

Informacion rreth bimësisë dhe zonave të mbrojura të rajonit

Në Shqipëri, zonat e mbrojtura sidomos 10 vjeçarin e fundit, janë kthyher në një objekt të rëndësishëm pune të disa institucioneve të vendit, të cilat kanë synuar në evidentimin, ruajtjen, mirëmenaxhimin e përdorimin në mënyrë të qëndrueshme të tyre.


Aktualisht në Shqipëri zonat e mbrojtura përbëjnë rreth 10% të territorit. Ndonëse shpallja e tyre është bërë gradualisht ndër vite, duke filluar që në vitin 1940, deri në vitin 2002 ka munguar një ligj mbi të cilin të mbështetet kategorizimi, ruajtaj e menaxhimi i këtyre zonave. Me daljen e këtij ligji në Qershor të 2002 duhet thënë se ka filluar një koncept i ri që përshtatet me atë bashkëkohor dhe që në tre vitet e fundit ka gjetur zbatim në rritjen me dyfish të territorit të vendit. Rrjeti i zonave të mbrojtura mbështetet në kategoritë menaxhuese të Qëndrës Ndërkombetare për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Themelet e zonave të mbrojtura janë hedhur që në vitin 1940 me shpalljen/krijimin e Rezervatit të Parë Shtetëror të Gjuetisë (Kune – Vain – Tale) në Lezhë dhe në Parkun Kombëtar "Mali i Tomorrit" në Berat. Në vitin 1956, në mbështetje të Dekretit " Mbi gjuetinë dhe peshkimin në ujrat malorë" u krijuar rezervati i gjuetisë në Rrushkull. Në vitin 1960 zyrtarisht krijohet Parku Kombëtar " Mali i Dajtit" dhe gjashtë vjet më vonë numri i tyre rritet në gjashtë (Thethi, Lura, Llogaraja, Dajti dhe Drenova). Parqe Kombëtare u shpallëm zona me vlera të rralla e të veçanta natyrore, shkencore, shoqërore e rekreative, ku ruheshin të pa prekur ekosistemet natyrore dhe shërbenin për ruajtjen e florës dhe faunës së egër. Deri në vitin 1970 numri i rezervateve të gjuetisë arriti në 15 zona pyjore e lagunore. Me dekretin e vitit 1977 u bë riklasifikimi i rezervateve të gjuetise dhe numri i tyre arriti në 25. Në vitin 1981 për herë të parë u vunë në mbrojtje shtetërore pasuritë natyroere të rralla, duke shpallur Monumente Natyre durët e grumbuj pyjorë me vlerë shkencore, biologjike, historike e didaktike

Monumentet Natyrore të Rrethit Librazhd (Sipas VKM)

Nr	Emertimi	16	Liqeni i Floqit
1	Mështenka e Qarishtës	17	Liqeni i Shebenikut
2	Pylli i Stravajt	18	Liqeni i Varrit të Plakës
3	Druri i Bizgës	19	Rrapi i Bërzeshtës
4	Vrima e Dardhës së Ariut	20	Rrepet e Gurakuqit
5	Vrima e Stërqokave	21	Mani i çupit
6	Shpella e Hasanit	22	Rrapi i Hotolishtit
7	Shpella e Shkëmbit të Bletës	23	Rrapi i Taksimit
8	Pusi i Faqes së Madhe	24	Rrapi i Gizaveshtit
9	Shpella e Kosharishtit	25	Ahet e Fushe Gurrës
10	Shpella e Pishkashut	26	Pylli i Barkmadhit Kostenjë
11	Shpella e malit të Letmit		
12	Sofra e Skënderbeut		
13	Burimi i Studnës		
14	Gurra e Kosharishtës		
15	Liqenet e Rajcës		

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

Harta e zonave të mbrojtura në Shqipëri



Besmira Niko

Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

Monumentet e Kulturës së Rrethit Librazhd				
Nr	Emertimi	**Kategoria**	**Vendodhja**	
1	Banesa e Arif Snallës	**Kategoria**: I	**Vendi**: Kostenje **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	
2	Banesa e Gani Allushit	**Kategoria**: I **Tipologjia**: Kishe **Fusha**: Arkitekture	**Vendi**: Zdrajsh **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	Gjerësi: 41.267833 Gatësia: 20.382306
3	Banesa e Hazis Lalës	**Kategoria**: I **Tipologjia**: Shtepi **Fusha**: Arkitekture Dhe Urbanistike	**Vendi**: Rinas **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	Gjerësi: 41.340111 Gatësia: 20.293222
4	Banesa e Ibrahim Koçit	**Kategoria**: I	**Vendi**: Prodan **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	
5	Banesa e Kamber Albrahimit	**Kategoria**: I	**Vendi**: Mëxixë **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	
6	Banesa e Kamber Dishës	**Kategoria**: I	**Vendi**: Kostenje **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	
7	Banesa e Osman Likës	**Kategoria**: I	**Vendi**: Prodan **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	
8	Banesa e Qamil Cenit	**Kategoria**: I	**Vendi**: Gurakuq **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	
9	Banesa e Shaqir Ballës	**Kategoria**: I **Tipologjia**: Shtepi banimi **Fusha**: Arkitekture Dhe Urbanistike	**Vendi**: Kostenje **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	Gjerësi: 41.341333 Gatësia: 20.295528
10	Banesa e Xhevdet Tomës	**Kategoria**: I **Tipologjia**: Shtepi **Fusha**: Arkitekture Dhe Urbanistike	**Vendi**: Orenje **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	Gjerësi: 41.284639 Gatësia: 20.211908
11	Banesa e Zyra Kocit (Librazhd)	**Kategoria**: I	**Vendi**: Orenje **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	
12	Guri i Pishkashit	**Kategoria**: I	**Vendi**: Pishkash **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	
13	Kalaja në fshatin Lunik	**Kategoria**: I	**Vendi**: Lunik **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	
14	Kalaja në fshatin Rrajce	**Kategoria**: I	**Vendi**: Rrajce **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	
15	Kalaja e Skënderbeut (Dardhë)	**Kategoria**: I	**Vendi**: Dardhë **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	
16	Kisha në shpellën e fshatit	**Kategoria**: I	**Vendi**: Koshorisht	

Besmira Niko

Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

	Kosharishte		**Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	
17	Kisha në shpellën e Qafë Thanës	**Kategoria**: I	**Vendi**: Urake **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	
18	Kompleksi i Shtatë Çezmave të Moisi Golemit	**Kategoria**: I	**Vendi**: Berzështe **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	
19	Muret e Kalasë te Qafa e Kalit të Gjergjit	**Kategoria**: I	**Vendi**: Qukës - skenderbej **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	
20	Rrënojat e urës antike të Haxhi Beqarit	**Kategoria**: I **Tipologjia**: Ure **Fusha**: Arkitekture	**Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	Gjerësi: 41.163417 Gatësia: 20.226778
21	Shpella e Gurit "Guri i Muzhaqit"	**Kategoria**: I	**Vendi**: Orenje **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	
22	Stacioni Romak tek Hanet e Prosekut	**Kategoria**: I **Tipologjia**: Hane **Fusha**: Arkitekture	**Vendi**: Dardhe **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	Gjerësi: 41.136639 Gatësia: 20.343639
23	Traseja e Via Egnatias (Qukës)	**Kategoria**: I	**Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	
24	Ura Antike e Keçit	**Kategoria**: I	**Vendi**: Mirake **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	
25	Ura e Gurit (Qukës)	**Kategoria**: I **Tipologjia**: Ure **Fusha**: Arkitekture	**Vendi**: Qukes **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	Gjerësi: 41.132861 Gatësia: 20.227028
26	Ura e Kamares	**Kategoria**: I **Tipologjia**: Ure **Fusha**: Arkitekture Dhe Urbanistike	**Vendi**: Mirake **Bashkia**: Librazhd **Qarku**: Elbasan	Gjerësi: 41.170611 Gatësia: 20.262083

Bashkia Prrenjas nga pikpamja mjedisore paraqitet me një biodiversitet shumë të pasur tipike për zonat me klime mesdhetare kodrinore të përfaqësuar nga nënzona mesdhetare kodrinore qendrore, nënzona mesdhetare qendrore paramalore dhe nënzona mesdhetare malore

Kushtet klimaterike, pedologjike dhe lartësia mbi nivelin e detit ndikojne në larmishmërine morfologjike dhe strukturale të biodiversitetit, ekosisteme, habitateve, peisazheve natyrore të hapësirës së bashkisë. Ky biodiversistet më tipik është në njësitë administrative të Rrajcës, Stravaj dhe Qukës.

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

FLORA:

Përsa i përket florës, janë bërë përpjekje për të listuar bimët mjekësore të Bashkisë që nga viti 1980,atëherë u regjistruan në nivel vendi 19 lloje. Më vonë, në vitin 1988, u be regjistrimi i bimeve mjekësore nga një grup pune i specialiteteve të ndryshme. Pjesa e konsiderueshme dhe me mjaft vlera natyrore dhe ekonomike është bimësia shkurro – drunore e kultivuar si arrat (Gj, Junglans), Qershitë (Gj. Cerasus sp), shegë (Gj. Punica), mollët (Gj. Malus), lajthitë (Gj. Corillus), ftonjtë (Gj, Cidona), dardhat (Gj. Pirus) kumbullat (Gj, Prunus,) hardhitë (Gj.Vitis). Qendra e bashkisë karakterizohet nga bimësia decorative. Flora barishtore në tërësinë e saj është mjaft e zhvilluar për shkak të kombinimit të faktorëve ekologjik, reshjeve, variacionit të temperaturave etj.

Përfaqësuesit specifik të Florës në zonë janë:

Pjesa e konsiderueshme dhe me mjaft vlera natyrore dhe ekonomike është bimësia shkurro – drunore e kultivuar si arrat (Gj, Junglans), Qershitë (Gj. Cerasus sp), shegë (Gj. Punica), mollët (Gj. Malus), lajthitë (Gj. Corillus), ftonjtë (Gj, Cidona), dardhat (Gj. Pirus) kumbullat (Gj, Prunus,) hardhitë (Gj.Vitis).

FAUNA:

Fauna është pasqyrim i gjendëj së florës dhe shoqërimeve bimore. Në përgjithësi takon larmishmëri gjitarësh por si më të rëndësishëm dhe që duhen evidentuar për nga statusi përmendim Ariu (Ursus arctos), Ujku (Canis Lupus),Rrëqebullin (Felis lynx), Dhi e egër (Rupicapra rupicapra) Derri (Sus scrofa), Lepur (Lepus europeus) etj. Shpendë të zonave kodrinore e malore (Gj. Accipiter, Gj. Corcus, Gj. Pirrohocvorax, Gj. Falco, Gj. Sclrolopacides, Gj. Aquila, Gj. Alectoris, Gj. Hiudinidea etj) zvarranikë të ndryshëm, amfibë etj. Pra fauna është mjaft e pasur dhe atraktive

Përfaqësuesit specifik të Faunës në zonë janë:

Ariu (Ursus arctos), Ujku (Canis Lupus),Rrëqebullin (Felis lynx), Dhi e egër (Rupicapra rupicapra) Derri (Sus scrofa), Lepur (Lepus europeus) etj. Derri i Egër (Sus scrofa), Lepuri i egër (Lepus europaeus), Kunadhja (Martes Foina), Dhelpra(Vulpes vulpes), derri i egër (sus Skrota) dhia e eger kaprolli

TË DHËNAT DEMOGRFIKE SOCIAL-EKONOMIKE E KULTURORE TË ZONËS

Demografia : Popullsia

Popullsia e Bashkisë Prrenjas është pjesë strukturale dhe funksionale e zhvillimeve

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

demografike që karakterizojnë hapësirën territorial të Qarkut të Elbasanit, ku paraqiten dinamika të ngjashme me ato të kryeqytetit, pra ku popullsia në moshë pune është rreth 45% dhe koefiçentet e varësisë së moshës së ulët dhe të lartë përqëndrohen në vlerat mesatare kombëtare (përkatësisht 30% dhe 15 %)

Bashkia e Prrenjasit paraqet një përqindje të popullsisë në moshë pune prej 68.3% dhe një koefiçent varësie resultant prej 31.7%. Ajo paraqet plakje më të ulët të popullsisë (8.0%) krahasuar me Cërrikun (11.6%). Popullsia e Bashkisë Prrenjas si aktivitet kryesore ka : për zonat rurale bujqësia, blegtoria, vreshtaria, pylltaria etj, ndërsa zona urbane ka patur si veprimtari primare ku përfshihej në mënyrë të konsiderueshme dhe banorët e zonave rurale mineralnxjerrjen në kanitierët e Pishkashit, Katjelit, Bushtricës, aktivitete tregëtare të thjeshta. Këto vitet e fundit janë aktivizuar disa burime veprimtarie alternative sikurse është ajo hidrike, turizmi malor etj.

Nr	Njesia Administrative	Censusi 2011	Gjendja civile 2011	Ndryshimi	Ndryshimi %
1	Stravaj	2427	3059	-632	-21%
2	Rrajcë	8421	10289	-1868	-18%
3	Prrenjas	5847	8459	-2612	-31%
4	Qukës	8211	10604	-2393	-23%
	Totali	**24906**	**32411**	**-7505**	**-23.15%**

2.5.2. Gjëndja social ekonomike e komunitit të zonës

Banorët e zonës janë tradicionale , me tradita të pasura dhe ruajnë marrëdhënje korrekte e respekti të ndërsjelltë ndaj njëri tjetrit. Popullata e krahines, shquhet per qetësi dhe respektim të ligjit. Është ndër të vetmet zona që ka ditur të ruajë qetësine dhe kur në zona të tjera ka patur anarki dhe thyrje të ligjit si psh në ngjarjet e vitit 1997.

Zona edhe pse është e pasur me resurse natyrore (mbitokësore dhe nënë-tokësore është në gjëndje të varfër ekonomike. Kujtojmë se mesatarja e të ardhurave të për frymë për rrethin e Prrenjass është gjithashtu mjaft më e ulët se ajo kombëtare.

Krahasimi i shpenzimeve për frymë na jep disa indikacione të rëndësishme: mesatarisht njësitë e qarkut Elbasan, ku bën pjesë dhe bashkia Prrenjas e rrethinat, shpenzojnë rreth 30% më pak se mesatarja kombëtare për banor. Kjo ndodh sepse investimet publike kanë munguar sidomos këto 30 vitet e fundit Për 40 vjet nuk ka patur asnje investim serioz në ndihmë te komunitetit, për të ndihëmuar sadopak zhvillimin ekonomik te zonës. Fale programit "Per rilindjen e qyteteeve te Shqiperise" jane bere disa investime ne qytet qe japin shprese per te ardhmen.

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

Arsimi dhe shendetesia në zonë

Komuniteti i zonës shquhet si arsim dashës dhe i etur për dije dhe kulturë. Në zonë funksionojnë shkolla, nga arsimi fillor deri ne arsimin e mesëm. Cilësia e arsimit nuk është në nivelin e kërkesave të kohës, por vitet e fundit janë marrë masa nga ministria e linjës në drejtim të përmirësimit të curiculave, pvrmirësimit të nivelit të informacionit dhe për rritjen e kërkesës gjatë kontrollit të dijeve tek nxënësit në të gjitha nivlet.

Shëndetësia në zonë lë për të dëshiruar. Ekziston një qëndër spitalore dhe disa qendra shendetesore zonale por gjithëmone ndihet mungesa e mjekut për shkak të migrimit dhe emigrimit te specialisteve. Meqenese shërbimi shëndetësor në fshatrat e lartëpërmendur nuk është në nivelin e duhur dhe numri i personelit mjekësor ëhstë i pamjaftueshëm ,ndaj banorët e zonës janë shpesh të detyruar të shkojnë në spitalet e Shkodres, e të Tiranës sipas rasteve për një shërbim më të mirë. **Bujqësia dhe blektoria**

Zona nën studim për VNM, siç kemi theksuar dhe më lart shtriehe ne terren malor të pyllëzuar e për rrjedhojë bujqësia është në nivel të papërfillëshëm ne aspektin e peshës ekonomike dhe ekstensive për nga rendimeti. Toka bujqësore shfrytëzohen parcelat e vogla ne dy anet e përrenjëve Franovisht dhe radicine. Në këto parcela kultivohen kulturat si Misër, Jonxhë, Fasule, Perime, për të plotësuar nevojat familjare. Zona kultivon pemtarine kryesisht drurët frutore si Arra, Kumbulla,

Fiku, Dardha, Ftoi etj. Perpunimi i tyre mbetet ne nivel primitiv duke i konservuar me metodat tradicionale

Në lidhje me blektorinë cilësojme se mbarështrohen: gjedhi dhe të imtat, kryesisht lopa,delja dhe dhia për mish dhe qumësht për nevojat e familjeve të tyre por dhe për tregëti. Gjithashtu për nevojat e transportit ,mbarështrohen edhe kafshët e punes,

Ne këtë zonë për të shfrytëzuar florën e pasur , kohët e fundit rritje ka marrë edhe bletaria e cila shquhet për prodhimin e mjaltit me cilesi te larta ushqyese dhe kurativ.

Infrastruktura në zonë telekomunikacini

Zona e Prrenjass lidhet me rrjetin rrugor kombëtar.. Ky akës përmirëson një pjesë të infrastrukturës rrugore te zonës. Pjesa tjetër e infrastrukturës rrugore, kryesisht ajo e fshatrave, lë për të dëshiruar. Janë rruge te pa asfaltuar dhe e pa mirëmbajtur. Kjo gjëndje, jo e favorëshme e infrastrukturës rrugore ka influenca negative si në jetën socale të komuniteti ashtu dhe në zhvilimin e ekonomise dhe tregetise së zones,

Furnizimi me energji elektrike në zonë, është përmirësuar kohët e fundit për shkak të rritjes së

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

prodhimit të energjise ne vend. Cilesojme se me ujrat e kesaj zone prodhohet nje sasi e konsinderueshme energjie elektrike per vendin Furnizimi me ujë nuk ka ndonjë investim për tu evidentur, por zona duke qënë e pasur me burime ujore ka lehtësuar problemin e furnizimit me ujë te komunitetit.

Telefonia është zgjidhur kryesisht me rrjtin mobil por në qëndra dhe istitucione ka të instaluara dhe linja të telefonise fikse.

Mjetet e komunikimit

Shërbimet postare dhe gazetat kryesore ofrohen vetëm në qendrat kryesore të banuara.Njësitë tregtare shesin materiale të tjera të informimit të përditshëm dhe javor. Rrethi i Prrenjass ka akses në stacionet kryesore televizive nga Shkodra e Tirana.Shërbimi telefonik kryhet kryesisht nga filialet portable ku në territorin në fjalë operojnë kompani të ndryshme.

Migrimi dhe Emigrimi

Edhe pse, siç kemi cilësuar më lart, zona ndodhet në kushte jo të favorëshme zhvillimi social-ekonomike dhe me infrastrukture të dobët, banorët e zonës pak kanë preferuar të lëvizin pranë qëndrave urbane. Ata janë munduar ta ndërtojnë jetën në zonën e tyre. Kjo është zona me tregues minimalë migrimi, krahasuar me krahinat e tjera të Shqipërise. Ndryshe janë treguesit e emigrimit.

Për të përmirësuar nevojat ekonomike te familjeve të tyre , shumë të rinjë kane emigruar në shtete fqinjë dhe në Europës kryesisht në Greqi, Itali, Gjermani, Angli etj.

B) INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE, NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË TIJ;

Burimet hidrike të zonës janë mjaft të pasura dhe të larmishme në formë. Burimi kryesor është rrjedhja e sipërme e shtratit të lumit Shkumbin që formon dhe grabenen më tipike të zonës. Së dyti ka mjaft burime ujore statike, pra liqenore (natyrore dhe artificiale) ku padyshim më të rëndësishme janë ato të liqeneve të Rrajcës, por edhe rezervuarët e krijuar krijojnë mjedis me impakt pozitiv mjedisor. Ujrat karakterizohen nga parametra fiziko – kimik dhe organoleptik të përshtatshëm për pirje por dhe për shfrytëzim në ekonomitë e njësive të vlerësuara sipas origjinës së tyre. Në zonën e zbatimit të këtij projekti nuk ka burime ujore të identifikuara në afërsi. Projekti i rikonstruskionit dhe asfaltimit të rrugës ndodhet në Qarkun Elbasan, Bashkia Prrenjas, rruga 'Unazë' dhe nuk ndodhet në brendësi apo në afërsi të burimeve ujore të rëndësishme si Lumenjtë kryesore, Liqene, Rezervuar apo Zona Bregdetare. Në afërsi të zonës

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

ndodhet vetëm Rezervuari i Prrenjasit i cili ndodhen në një largësi të konsiderueshme nga zona ku do të kryhen punimet e rikonstruksionit të rrugës. Burime ujorë të afërt jane Lumi i Shkumbinit, i cili ndodhet në jug – perëndim në largësi 5.7 km në vijë ajrore. Rezervuari i ujëmbledhës i Prrenjasti ndodhet pothuajse në jug të segmentit rrugor rreth 1.36 km.

Cilesia e lumenjve

Monitorimi i cilësisë së ujit është i rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e ujrave, identifikimin e shkaktarëve të ndotjes deri në dhënien e rekomandimeve përkatëse sipas porblematikave të identifikuara. Ky program monitorimi me një frekuecnë 4 herë/vit siguron një bazë të dhënash, të cilat përdoren në hartimin e Raporteve të Gjëndjes së Mjedisit, në hartimin e informacioneve në nivele lokal, kombëtar e ndërkombëtar, si dhe raportimet në Agjencinë Europiane të Mjedist.

Gjendja e treguesve mjedisor, ndikimi në mjedis dhe tendenca

Rrjeti i monitorimit është i shtrirë në lumenj, liqene, zona bregdetare dhe stacione pranë impianteve të trajtimit të ujrave të zeza. Bazuar në Urdhërin e Brendhsëm me datë 13.06.2017 me Nr. Prot 1464 mbi riorganizimin e proçesit të monitorimit të cilësisë së ujrave sipërfaqësore, cilësine e ajrit urban dhe monitorimin e zhurmave, i cili u pezullua më datë 22.05.2017 për shkak të mungesës së financimit për të realizuar monitorimet e programuara. Vlerësimi paraprak i cilësisë së lumenjve dhe liqeneve përcaktohet në bazë të parametrave fiziko – kimikë duke i krahasuar me normat e lejuara të përcaktuara në Direktivën Kuadër të Ujit të BE. Për klasifikimin e zonave bregdetare dhe stacionet pranë impianteve të trajtimit të ujrave të zeza i referohemi VKM 177 dt 31.03.2005, Norma e lejuara të shkarkimeve urbane nga impiantete e trajtimit.

Parametrat e analizuar në laborator

Sipas analizave të vlerësimit të gjëndjes së trupit ujor, kryesosht të lumit Shkumbin që përfaqëson arterien më të rëndësishme por edhe fluentin ujëmbledhës të pothuajse tërësisë hapsinorë të bashkisë rezulton se gjendja paraqitet si më poshte (pika e monituruar është në Qukës) :

- Përmbajtja e oksigjenit të tretur 9.5 mg/l pra e cilësisë së mirë (norma > 7)
- Përmbajtja e lëndëve organike e shprehur në nevoja biologjike për oksigjen ose NBO_5 , është shumë e ulët dhe klasifikohet e cilësisë së dytë.
- Përmbajtja e nevojës kimike për oksigjen NKO që është tregues i ndotjes kimike dhe organike është 4.36 mg/l
- Përmbajtja e fosforit total është 0.056 mg/l duke qenë vlerë në normë dhe ujrat konsiderohen të cilësisë së mirë

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

- Përmbajtja e nitriteve është 0.004 mg/l ora ujë i cilësisë shumë të mirë
- Përmbajtja e NH_4 (amoniakut) është 0.067 pra uji i cilësisë së dytë, gjendje e mirë
- Përmbajtja e nitrateve NO_3, vlerësohet i cilësisë shumë të mirë nën normën e lejuar < 0.8 mg/l

Duke marrë pikën monitoruese si pikë fundore të bashkisë lumi Shkumbin në këtë segment konsiderohet i cilësisë së dytë. Ndërsa të gjitha burimet ujore të mësipërme vlerësohen të cilësisë së parë, pra shumë të mirë. Ujrat nëntokësore janë më të ekspozuara potencialisht ndaj ndotësve për shkak të struktures gjeologjike, aftësisë infiltruese, mungesës së shtresës ekranizuese, shkarkimeve urbane, bujqësore dhe blegoriale të pakontrolluara por dhe të vendodhjes së aktiviteteve impaktuese pa studime hidrogjeologjike paraprake. Sipas analizave të elementëve kimik dhe anioneve e kationeve vlerësuese ujrat nëntokësore të zonës konsiderohen shumë të mirë.

C) INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TË MUNDSHME, NEGATIVE, NË MJEDIS, TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR;

INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR

Ky raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është hartuar bazuar në legjislacionin mjedisor për VNM dhe ka për qëllim që të parashikojë identifikojë vlerësojë dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin në mjedis të projektit të propozuar. Proçedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshi :

a) Proçesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis

b) Proçesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis

Objektivat afatshkurtër të VNM janë :

- Përmirësim nga pikpamja mjedisore të projektit të propozuar
- Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrën e duhur dhe me efiçencë
- Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit
- Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të Disponueshme të teknologjisë së propozuar për tu aplikuar
- Identifikon masat e duhura për zvogelimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit të propozuar

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

- Mundëson informimin e vendim marrësve duke gjykuar në miratimin ose jo të projektit dhe kushteve që duhet të vendosen në aktin e miratimit

Objektivat afatgjatë të VNM janë :

- Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/dëmitimet e pakthyeshme të mjedisit
- Ndikon në mbrojtjen e burimeve natyrore, peisazhet e natyrës dhe komponentët përbërës të ekosistemeve
- Përmirëson aspektet sociale – ekonomike të projektit
- Ndimon në realizimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit

PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Ky raport paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, hartohet me kërkesë të Investitorit Bashkia Prrenjas. Objekti i vlerësimit të këtij raporti është projekti për "Rikonstruksion dhe asfaltim rruga Unazë".

Realizimi i këtij projekti do të bëhet mbi bazën e standarteve dhe kushteve teknike CNR dhe ato Shqiptare si dhe të konsultuara me normat e vendeve të tjera. Projekt zbatimi për objektin "Rikonstruksion dhe asfaltim rruga Unazë" është përgatitur në përputhje me Detyrën e Projektimit të dhënë nga Bashkia Prrenjas dhe sipas PDV të miratuar të zonës në studim.

Projekt zbatimi i projektuar nga ana jonë dhe i koordinuar me Bashkinë Prrenjas dhe Këshillin Teknik është në përputhje me gjendjen aktuale dhe kërkesat e zonës për urbanizimin e saj dhe kthimin në kushte optimale jetese. Më poshtë jepet përshkrimi i projekt – zbatimit të pregatitur për objektin " "Rikonstruksion dhe asfaltim rruga Unazë"

Vendodhja në të cilën do të bëhet "Rikonstruksion dhe asfaltim rruga Unazë" ndodhet në Qarkun Elbasan, Bashkia Prrenjas. Rruga është projektuar duke marrë në konsideratë kryesisht parametrat gjeometrikë ekzistues të zonës në studim, si dhe kufizimet e tjera në zonë (objekte, shtylla). Është parashikuar ndërtimi dhe rikonstruksioni i plotë i rrjetit rrugor dhe, ndërtimi i kanalizimeve të Ujërave të zeza dhe ujërat e shiut të ndara, ndriçimit rrugor dhe linjave rezervë. Sensi i lëvizjes është bërë kryesisht me dy sense lëvizjesh. Përsa i përket punimeve mund të themi se nga vlerësimet paraprake të formacioneve gjeologjike të trupit të rrugës dhe intesitetit të trafikut për rrugën që do projektohet është përcaktuar dimensionimi paraprak i shtresave rrugore si më poshtë :

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

Llogaritja e shtresave rrugore është bërë me metodën CBR, sipas manualeve të AASHTO-s dhe " Pavement Design Catalogue 2001". Parametrat për aksin janë si më poshtë :

Dimensioni i shtresave rrugore Tipi 1

- Paketa e parashkuar e shtresave
  - Asfaltobeton 4 cm
  - Binder 6 cm
  - Stabilizant 10 cm
  - Çakëll 20 cm
  - Çakëll 20 cm
- Dimensionimi gjeometrik
  - Me gjërësi të gjurmës kaluece + kunetë 7 m (2x3.5m)
  - Kuneta nga të dy anët me gjërësi 0.5 m
  - Trotuare nga të dy anët me gjerësi 1.5m
  - Gjerësi të përgjithshme të kurorës së rrugës 11 m

Dimensioni i shtresave rrugore Tipi 2

- Paketa e parashkuar e shtresave
  - Asfaltobeton 4 cm
  - Binder 6 cm
  - Stabilizant 10 cm
  - Çakëll 20 cm
  - Çakëll 20 cm
- Dimensionimi gjeometrik
  - Me gjërësi të gjurmës kaluece + kunetë 4 m (2x2m)
  - Kuneta nga të dy anët me gjërësi 0.5 m
  - Trotuare nga të dy anët me gjerësi 1.5m dhe 1 m
  - Gjerësi të përgjithshme të kurorës së rrugës 7.5 m

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

Përshkrimi i proçeseve teknologjike të ndërtimit të objekteve të ndërtimit

Proçeset teknologjike në këtë projekt janë ato të fazës ndërtimore, nëpërmjet punimeve të ndërtimit, të cilat kryhen nga zhvilluesi dhe në vija të përgjithshme konsistojnë si më poshtë:

- Rrethimi i segmentit rrugor që do të rikonstruktohet
- Pastrimi i aksit rrugor dhe largimi i të gjitha mbetjeve inerte
- Punimet e ndërtimit dhe rikonstruksionit
- Instalimet inxhinierike, rrjeti elektrik, kanalet e shkarkimit të ujëarave, etj
- Sistemimi i rrugëve dhe trotuarëve

Lëndët e para

Lëndët e para të përdorura janë kryesisht llaçi i betonit, asfaltobeton, çakëll, rërë, zhavor, pllaka betony, të cilat blihen të gatshme nga firmat e prodhimit të betonit dhe asfaltobetonit në zonë, si dhe instalimet inxhinierike për ndriçim. Shkarkimet e ujërave të zeza do të lidhen me sistemin ekzistues të kanalizimeve të zonës i cili në rrugën Unazë është i amortizuar prandaj dhe do të ndërhyet,

Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte)

Ky vlerësim kryhet në baze të ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 "Për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" i ndryshuar dhe kërkesave të VKM – së Nr. 686 datë 29.07.2015 "Për zhvillimin e proçedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis" dhe ka si synim identifikimin, vlerësimin dhe parandalimin e ndotjes së mjedisit, me qëllim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërise, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizike dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë

Ndikime të rëndësishme gjatë ndërtimit

Shkarkime në ujë

Nuk këmi ndotje të ujërave nëntokësore. Ujrat që dalin nga aktiviteti i ndërtimit të objektit janë ujëra të cilat lindin si rrjedhojë e aktivitetit të lagies së kantierit, larjes së gomave ë automjeteve, betoniereve dhe ujërat e rreshjeve nga kushtet atmosferike. Gjatë punimeve, në varësi edhe të rreshjeve të shiut, mund të grumbullohet sasi e konsiderueshme e ujrave dhe si rrjedhojë mund të jetë i nevojshëm grumbullimi i këtyre ujërave dhe orientimi i tyre në sistemin e kanalizimeve pjesërisht ato filtrojnë nëntokë. Si rrjedhojë punimet e ndërtimit nuk duhet të tejzgjaten dhe të

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

kalojnë afatet e përcaktuara në lejen e ndërtimit. Nuk duhet të shkarkohen lëndë të dëmshme në mjedisin e kantierit pasi mund të filtrojnë së bashku me ujrat e rreshjeve dhe si rrjedhoje të ndotin ujrat nëntokësore. Në kantier nuk do të magazinohen material të rrezikshme dhe si rrjedhojë nuk do të ketë ndotje të ujrave nëntokësore ose sipërfaqësore. Mundësitë e ndotjes mund të vijnë vetëm nga dedhja e hidrokarbureve ose e lubrifikantëve gjatë furnzimit të mjeteve të rënda të punës, kjo vetëm në raste avarish jo në kushte normale pune. Një factor tjetër mund të jenë ujërat e pastrimit e të larjes së kazanëve të betoniereve gjatë shkarkimit të betonit në kantier. Këto të fundit nuk duhet të shkarkojnë ujrat në çdo mjedis rrethanor ato duhet të shkarkohen në mjedise të caktuara dhe në kantierët e prodhimit të betonit.

Emetimet në ajër

Emetimet në ajër vijnë nga përhapja e pluhurave të materialeve të ndërtimit dhe mbetjeve inerte që dalin gjatë punimeve të gërmimit të akseve rrugore që do të ndërtohen dhe rikonstruktohen. Gjithashtu djegia e lëndës që shkaktohet nga automjetet që frekuentojnë këtë ambient, si dhe në raste të rralla kur ka mundesë të energjisë elektrike dhe do të lindë nevoja për ndezjen e gjeneratori. Nga punimet ndërtuese do të ketë përhapje të pluhurave nga qarkullimi i mjeteve. Përdorimi i rërës, çakullit, proçeset e betonimit dhe shtrimit të sipërfaqeve përreth, si dhe nga transporti i automjeteve të mbetjeve inerte të prodhuara gjatë ndërtimit. Këto mjete duhet të plotësojnë patjetër kushtet teknike të qarkullimit rrugor, të mos ngarkohen më shumë se kapaciteti i projektuar, të mbulohet karroceria me mushama të posaçme si dhe të lahen rregullisht kur dalin nga sheshi i ndërtimit dhe nga kantieri i prodhimit të betonit, të inerteve apo në sheshin e depozitimit të dheut të gërmuar.

Zhurmat që prodhohen vijnë kryesisht nga aktiviteti ndërtimor, të tilla si : nga mjetet rrugore, zhurma nga trafiku i rënduar i krijuar për shkak të punimeve në këto akse rugore, përdorimi i gjeneratorëve, zhurma e prodhuar nga vetë përsonat që do të punojnë në këtë kantier, proçeces e hedhjes së betonit, asfaltobetonit, pasisjeve të prerjes së pllakave të betonit etj. Punëtorët që mund të ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund të përdorin masa mbrojtëse për shqisat e degjimit.

Më konkretisht, zonat e ndotjes akustike ndahen në tre nivele ndotjeje akustike. (Normat)

Nr	Zonë	Db
1	L1 ≥ 65 L2 55	64.9 L3 45
2	L1 ≥ 65 L2 55	64.9 L3 45
3	L1 ≥ 65 L2 55	64.9 L3 45

Tab 10. Zonat e ndotjes akustike ne tre nivele

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

Akse rrugore:

Nr	Tag	L1	L2	L3
1	Superstradë	60m	220m	500 m
2	Linjë kryesore e autostradës	50m	190m	400m
3	Autostradë= primare	35m	160m	300m
4	Autostradë =sekondare	-	80m	125m
5	Autostradë =terciare	-	35m	65m

Tab 11. Zonat e ndotjes akustike ne akset rrugore

Rrjet hekurrudhor:

Nr	Tag	L1	L2	L3
1	Hekurudhat = [traseja, binar i ngushtë, e ruajtur]	30m	60m	100 m
2	Transporti hekurudhor = [hekurudhë e lehtë, tramvajë, teleferik, tren me një shinë]	-	30m	60m

Tab 12. Zonat e ndotjes akustike ne rrjetin hekurudhor

Zona industriale dhe zona tregtare:

Nr	Tag	L1	L2	L3
1	Përdorimi i tokës-industrial	-	50m	100 m
2	Përdorimi i tokës - njësi	-	70m	180m

Tab 13. Zonat e ndotjes akustike ne industri dhe tregeti

Ambiente rekreative:

Nr	Tag	L1	L2	L3
1	dyqan=[të çdo lloji]	-	30m	65m
2	ndotje e ulët=[bar, zgarë, kafe, kënd për birra, biergarten, fast food, kënd ushqimi, akullore, pub,	-	35m	75m
3	Ndotje e lartë =[kinema, kazino, klub nate, lojra fati teatër, qendra komunitare]	40m	70m	150m
4	për kohën e lirë=[plazhe, resort, zone noti, park uji]	35m	55m	75m
5	tourizmi=[zona kamping, muze, zona pikniku, parqe, kopësht zoologjik	35m	55m	75m

Tab 14. Zonat e ndotjes akustike ne ambientet rekreative

Ambiente sportive:

Nr	Tag	L1	L2	L3
1	Sporte= [futboll, futboll amerikan, futboll kanadez, volejboll, bajsboll, basketboll, volejboll në plazh, gara me biçikleta (bmx), ndeshje gjelash, ndeshje qensh, cricket, fushë hockey, gara me kuaj, hockey në akull, patinazh në akull, gara me pengesa, gara me makina, rugby league, rugby union, qitje, tenis, ski në ujë]	40m	60m	80 m

Tab 15. Zonat e ndotjes akustike ne ambientet sportive

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

Ndikimi në tokë

Këto proçese në përgjithësi nuk ndikojnë negativisht në tokë, pasi proçeset ndërtimore do të jenë kryesisht punime rikonstruksioni të rrugëve ekzistuese.

Ndikimi në Biodiversitet

Ky zhvillim nuk prek hapësirat e gjelbra të qytetit pasi punimet e rikonstruksionit do të kryhen në rrugë ekzistuese të Bashkisë Prrenjas. Sipas verifikimeve të kryera në portalin http//:ëëë.asig.gov.al zona në vlerësim nuk bën pjesë në zonat e mbrojtura me ligj

Mbetjet e prodhuara

Mbetjet inerte që dalin si rezultat i punimeve të rikonstruksionit të rrugës janë të llojit dhe, argjile, gure dhe metale nga sinjalistika dhe ndriçimi që do të hiqen nga punimet që do të kryhen. Të gjitha këto mbetje jane 100 % të rikuperueshme. Këto mbetje duhet të menaxhohen në bashkëpunim me Njësinë e Qeverisjes Vendore dhë firmën pastruese të territorit dhe në përputhje me VKM Nr. 575, date 24.06.2015 " Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte". Sipas hirearkisë së Menaxhimit të Mbetjeve, mbetjet inerte që përfitohen gjatë prishjes së rrugës ekzistuese duhet të dërgohen për rikuperim dhe ripërdorim në pika grumbullimi ose vend depozitime të caktuara nga Njësia e Qeverisjes Vendore. Në mungesë të kushteve për rikuperimin e këtyre mbetjeve, ato duhet të dërgohen për rikuperim në landfill në përputhje me VKM Nr.575 datë 24.06.2015 të cituar më sipër. Mbetje të ngurta të tjera që prodhohen nga ndërtimi në kantier janë mbetjet e ngurta urbane si plastike, qelqi, material letre, metale, mbetje organike.

Referuar VKM Nr.99 datë 18.02.2005 "Për miratimin e katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve", mbetjet që prodhohen klasifikohen me kodet :

17 01 01	Beton
17 01 02	Tulla
17 01 03	Tjegulla dhe qeramika
17 02 01	Dru
17 02 02	Qelqe
17 02 03	Plastikë
20 01 01	Letër dhe karton
20 01 02	Qelq
20 01 39	Plastikët
20 01 40	Metalet

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

Ndikime të rëndësishme gjatë funksionimit

Shkarkimi në ujë

Ky projekt nuk do të shoqërohet me ndotje të ujravë nëntokësore. Ujrat do të shkarkohen në sistemin e kanalizimeve të zonë, i cili edhe ai do të rikonstruktohet pjesërisht në disa segmente rrugore. Gjithashtu ujrat e shiut do të orientohen përgjatë sistemit të kullimit të ujrave të shiut që do të ndërtohet i ri.

Ndikime të tjera

Përsa i përket sistemit të ndriçicimit, rekomandojmë projektimin e një skeme ndriçimi sa më efiçente. Aplikimi i teknologjive më të reja dhe ekonomike në fushën e ndriçuesve artificial si llambat LED, sistemet e ndezjes dhe fikjes automatike, etj

Përdorimi i llambave LED
Përdorimi i llambave LED kanë një jetëgjatësi më të madhe se llambat fluoreshente dhe llambat e zakonshme

Ç)NJË PËRSHKRIM PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMA, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE;

PËRSHKRIMI I SHKARKIMEVE TË MUNDHSMË NË MJEDIS

Informacion për shkarkimet në mjedis

Nuk këmi ndotje të ujërave nëntokësore. Ujrat që dalin nga aktiviteti i ndërtimit të objektit janë ujëra të cilat lindin si rrjedhojë e aktivitetit të lagies së kantierit, larjes së gomave ë automjeteve, betoniereve dhe ujërat e rreshjeve nga kushtet atmosferike. Gjatë punimeve, në varësi edhe të rreshjeve të shiut, mund të grumbullohet sasi e konsiderueshme e ujrave dhe si rrjedhojë mund të jetë i nevojshëm grumbullimi i këtyre ujërave dhe orientimi i tyre në sistemin e kanalizimeve pjesërisht ato filtrojnë nëntokë. Si rrjedhojë punimet e ndërtimit nuk duhet të tejzgjaten dhe të kalojnë afatet e përcaktuara në lejen e ndërtimit. Nuk duhet të shkarkohen lëndë të dëmshme në mjedisin e kantierit pasi mund të filtrojnë së bashku me ujrat e rreshjeve dhe si rrjedhoje të ndotin ujrat nëntokësore. Në kantier nuk do të magazinohen material të rrezikshme dhe si rrjedhojë nuk do të ketë ndotje të ujrave nëntokësore ose sipërfaqësore. Mundësitë e ndotjes mund të vijnë vetëm nga dedhja e hidrokarbureve ose e lubrifikantëve gjatë furnzimit të mjeteve të rënda të punës, kjo vetëm në raste avarish jo në kushte normale pune. Një factor tjetër mund të jenë ujërat e pastrimit e të larjes së kazanëve të betoniereve gjatë shkarkimit të betonit në

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

kantier. Këto të fundit nuk duhet të shkarkojnë ujrat në çdo mjedis rrethanor ato duhet të shkarkohen në mjedise të caktuara dhe në kantierët e prodhimit të betonit. Këto mjete duhet të plotësojnë patjetër kushtet teknike të qarkullimit rrugor, të mos ngarkohen më shumë se kapaciteti i projektuar, të mbulohet karroceria me mushama të posaçme, si dhe të lahen rregullisht kur dalin nga sheshi i ndërtimit dhe nga kantieri i prodhimit të betonit, të inerteve apo në sheshin e depozitimit të dheut të gërmuar. Zhurmat që prodhohen vijnë kryesisht nga aktiviteti ndërtimor, të tilla si : nga mjetet rrugore, zhurma nga trafiku i rënduar i krijuar për shkak të punimeve në këto akse rrugore, përdorimi i gjeneratorëve, zhurma e prodhuar nga vetë përsonat që do të punojnë në këtë kantier, proçeset e hedhjes së betonit, asfaltobetonit, pajisjeve të prerjes së pllakave të betonit etj. Punëtorët që mund të ndohedhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund të përdorin masa mbrojtëse për shqisat e dëgjimit. Këto proçese në përgjithësi nuk ndikojnë negativisht në tokë, pasi proçeset ndërtimore do të jenë kryesisht punime rikonstruksioni të rrugëve ekzistuese. Ky zhvillim nuk prek hapësirat e gjelbra të qytetit pasi punimet e rikonstruksionit do të kryhen në rrugë ekzistuese të Bashkisë Prrenjas. Sipas verifikimeve të kryera në portalin http//:ëëë.asig.gov.al zona në vlerësim nuk bën pjesë në zonat e mbrojtura me ligj. Mbetjet inerte që dalin si rezultat i punimeve të rikonstruksionit të rrugës janë të llojit dhe, argjile, gure dhe metale nga sinjalistika dhe ndriçimi që do të hiqen nga punimet që do të kryhen. Të gjitha këto mbetje jane 100 % të rikuperueshme. Këto mbetje duhet të menaxhohen në bashkëpunim me Njësinë e Qeverisjes Vendore dhë firmën pastruese të territorit dhe në përputhje me VKM Nr. 575, date 24.06.2015 " Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte". Sipas hirearkisë së Menaxhimit të Mbetjeve, mbetjet inerte që përfitohen gjatë prishjes së rrugës ekzistuese duhet të dërgohen për rikuperim dhe ripërdorim në pika grumbullimi ose vend depozitime të caktuara nga Njësia e Qeverisjes Vendore. Në mungesë të kushteve për rikuperimin e këtyre mbetjeve, ato duhet të dërgohen për rikuperim në landfill në përputhje me VKM Nr.575 datë 24.06.2015 të cituar më sipër. Mbetje të ngurta të tjera që prodhohen nga ndërtimi në kantier janë mbetjet e ngurta urbane si plastike, qelqi, material letre, metale, mbetje organike.

Ndikimi në Erozion

Siç është shpjeguar edhe në studimin gjeologjik toka ku do të ndërtuar vepra është e qëndrueshme. Gjate punimeve te ndertimit ka pika qe jane ndikuar nga germimet dhe keto jane vatra te degradimit fizik dhe erozioni te tokës për shkak të terrenit te thyer.

Në keto zona duhet nderhyre, duke bere sistemimet e nevojshme ne harmonike me relievin dhe mbrojtje me mure gabiona ku eshte e nevojshme.

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

DH) TË DHËNA PËR SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPËSINORE TË NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDIS, QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT, DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË;

Ndikimi në mjedisin e zonës do të ketë efektet e tij në një distancë jo shumë të gjerë, me dhjetra ose qindar metra, pra në një distancë jo më të largët se 100 – 200 m. Ky ndikim do të jetë i përkohshëm dhe nuk është me veti akumuluese në mjedis. Ndiki në peizash do të jetë i përkohshëm për fazën e ndërtimit dhe i përhershën nga ndërtimi i strukturave mbi tokë, ky impact shtrin efektet e tij shumë më gjërë,

D) MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR TË SIPËRFAQES NË GJENDJEN E MËPARSHME, SI DHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN;

Rehabilitimi i mjedisit të ndikuar dhe mundësia e kthimit të tij në gjendjen e mëparshme

Zhvilluesi vetë ose nëpërmjet firmës ndërtuese të kontraktuar, pas përfundimit të ndërtimit të infrastrukturës përkatëse do të kryejë rehabilitimin e plotë të sipërfaqeve të dëmtuara, duke i shtruar ato me beton, asfaltobeton ose pllaka. Në përfundim të projektit do të krijohet nje pamje më e kendshme një zonë më e paster nga pluhuri dhe balta si dhe do të lehtësoje dhe përmiresojë jëtën e banorëve të kësaj zone. Përsa i përket mbjelljes së bimësise në këtë projket jan parashikuar të mbillen pemë decorative.

Ne menyre te pergjithshem do te japim disa prej masave qe duhet te zbatohen nga zhvilluesi ose firma ndertuese per zbatimin e projektit. Disa prej masave kryesore qe do te ndermerren jane permendur ne menyre te permbledhur si me poshte shenuar:

- Lagia e shesheve te pa shtruara gjate punimeve te ndertimit dhe larja e automjeteve para daljes nga kantieri per te minimizuar ngritjen e grimcave te ngurta ne ajer.
- Mbetjet e ngurta urbane qe do te prodhohen ne objekt te depozitohen ne vendet e percaktuara nga NJ.Q.V dhe te vendosen kosha te mjaftueshem pergjate trotuareve.
- Mbetjet inerte apo te pastrimit te sheshit te ndertimit te menaxhohen ne menyre te integruar nga subjekte te kontraktuara per kete qellim.
- Sistemi i shkarkimit te ujerave urbane te jete i lidhur me sistemin e kanalizimeve te zones, fillimisht me rrjetin ekzistues, ne rast se dote ndertohet i ri.
- Vendosja e sinjalistikes gjate kohes se punimeve, per shmangien e aksidenteve, si dhe sinjalistikes rrugore ne fund te procesit te punimeve.
- Aplikimi i sistemit te ndri imit me llamba LED.

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

- Te orientohet trafiku i krijuar ne nje rruge tjeter, si dhe levizja e mjeteve te kryhet ne rruge me dy sense levizje me qellim shmangien e bllokimit te rrugeve.
- Te respektohen oraret e qetesise publike dhe te mos punohet ne oret e vona.
- Automjetet e transportit te qarkullojne me shpejtesi te ulet ne zonat e banuara.
- Gjate transportit te perdoren mushamate e kamionave per te shmangur perhapjen e dheut e te inerteve ne rruget e qytetit.
- Te shmangen ore e pikut te trafikut per transportin e materieleve ndertimore.
- Automjetet e transportit te lahen dhe pastrohen ne menyre periodike para daljes nga kantieri apo nga objekti i prodhimit te betonit.
- Te sigurohet menjehere nje vend i miratuar nga autoritetet per depozitimin e mbetjeve inerte qe duhet te largohen nga objekti.
- Subjekti te jete ne dijeni te gjithe kuadrit ligjor per mjedisin dhe detyrimeve qe lindin ne zbatim te tij.
- Punimet e rehabilitimit te kryhen branda afatit te punimeve te paracaktuar.

Si perfundim mund te themi se rikonstruksioni i rruges "Unazë", paraqet mjaft interes ne rritjen e mireqenies se komunitetit ne pergjithesi qe banon ne keto rruge dhe te mbare qytetit ne teresi. Rruget e projektuara ruajne pergjithesisht gjurmet e rrugeve ekzlstuese. Kjo zgjidhje eshte bere me synim per te ruajtur ne maksimum objektet e banimit duke ruajtur objektivin qe ne nje te ardhme te afert kjo zone te zgjerohet sipas planit te ri rregullues dhe zgjerimi dhe rregullimi i rrugeve te mos jete objekt prishje dhe shpronesimesh, par i zhvillimit te zones. Trajtimi i ketyre rrugeve me te gjithe elementeet e infrastruktures rrugore dhe te atyre inxhinierike do tv bejne qe ata te funksionijne mire ne te gjitha drejtimet, duke i sherbyer komunitetit me te gjitha komponentet e nevojshme jetesore. Rehabilitimi i tyre do te beje qe cilesia e jetes ne tote ndryshoje rrenjesisht.

NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDOSIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË)

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhoje edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim te mjedisit nderkufitar. Projekti nuk ndikon ne cenimin e sigurise se jetes dhe shendetit as te shteteve fqinje, as te qendrave te banuara te rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilesia e ajrit ne kontekstin nderkufitar. Per kete kapitull, nuk kryhen vleresime dhe analiza te detajuara per shkak te vendodhjes se projektit ne brendesi te kufirit shteteror dhe distances qe ai ruan me kufirin dhe shtetet fqinje.

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

Kerkesa ligjore per kryerjen e monitorimit:

Ligji nr. 10431 date 09.06.2013 "Për mbrojtjen e mjedisit", krëu VI "Monitorim i gjendjes së mjedist"

Subjekti është i detyruar të kryejë monitorimet periodike sipas kërkesave të përcaktuara

Ligji Nr. 10266 date 15.04.2010	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
Ligji Nr. 9774 date 12.07.2007	Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmes në mjedis
VKM Nr 1189 datë 18.11.2009	Për Rregullat dhe Procedurat per Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombetar të Monitorimit të Mjedisit
VKM Nr 103 datë 31.03.2002	Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërise
VKM Nr 435 datë 12.09.2002	Për monitorimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërise
VKM Nr 803 datë 27.11.2003	Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit
Udhëzim Nr.8 datë 27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara
Udhëzim Nr.6527 datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimt e gazrave dhe zhurmave shkarkuar nga mjetet rrugore dhe mënyra e kontrollit të tyre.

Plani i monitorimit

Me qene se kemi te bejme me rikonstruksion te rrugeve "Sabaudin Gabrani" dhe "Leka i Madh" nevojitet nje monitorim i vazhdueshem i shkarkimeve ne ajer dhe zhurmave ne kantierin e ndertimit, i kryer me laboratore te akredituar jo vetem ne slperfaqen e objektit e kantierit ndertimor, por dhe ne nje zone mbi 200 m per rreth.

Plani i monitorimit dote konsistoje ne

- Monitorimi i parametrave gjeometrike te parshikuar ne projekt.
- Monitorimi i zones se mundshme te shperndarjes se plLrhurit dhe grimcave gjate aktivitetit te rikonstruskionit te rrugeve dhe magazinimit te lend eve te para.
- Monitorimi i nivelit te zhurmave te gjeneruara gjate aktivitetit ndertimor dhe marrja e masave perkatese te parashikuara ne projekt, per parandalimin e tij.

Objektivat kryesore te monitorimit jane:

- Per te zbuluar ndryshimet dhe per te karakterizuar saktesisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit te burimeve.
- Per te siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) te burimeve dhe shkaqeve te tyre.
- Per te evidentuar cilesine e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetesor, me synim per te marre masat e nevojshme per permiresimin e tyre.
- Per te vleresuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve per menaxhimin e burimeve natyrore.

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

Monitorimi eshte detyre e shoqerise investitore ne nivel individual per pikat (;l, (;2, (;5, (;6, (;7, 8 te Vendimit Nr.1189. dat 18.11.2009 "Per monitorimet ne Republiken e Shqiperise".

lnvestitori ose firma ndertuese do te monitoroje keto tregues te trysnise ne mjedis vetem gjate fazes se punimeve dhe konkretisht elementet e meposhtem:

Per ajrin duhet te monitoroje Lenden e Ngurte Pezull (LNP) dhe zhurmat (dB).

Frekuenca e monitorimeve do te percaktohet sipas kuadrit ligjor do 6 muaj te kryhen matjet dhe do tre ose gjashte muaj te dorezohet nje relacion periodik i shkurter ku te pasqyrohen punimet e kryera te shoqeruara me foto, masat e marra per reduktimin e ndotjes ne mjedis dhe menyren e zbatimit te tyre.

Regjistlmi i te dhenave mjedisore

Per te ruajtur te dhenat mjedisore te veprimtarise dote pergatitet dhe mbahet nje regjister i ve ante ku do te pasqyrohen te gjitha parametrat e monitoruar nga investitori ose firma ndertuese, mirembajtja dhe perditesimin e regjistrit nga drejtuesi teknik i punimeve.

Nga sa me siper duke u nisur edhe nga kohezgjatja e punimeve per rikonstruksionin e rrugeve, investitori ose subjekti ndertues duhet te marre dhe zbatoje disa masa lidhur me shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative, te cilat poi listojme si me poshte:

- Lagia e shesheve te pa shtruara gjate punimeve te ndertimit dhe larja e automjeteve para daljes nga kantieri per te minimizuar ngritjen e grimcave te ngurta ne ajer, sidomos gjate muajve me thatesire.
- Mbetjet e ngurta urbane qe do te prodhohen ne objekt te depozitohen ne vendet e percaktuara nga NJ.Q.V dhe te vendosen kosha te mjaftueshem pergjate trotuareve.
- Mbetjet inerte apo te pastrimit te sheshit te ndertimit te menaxhohen ne menyre te integruar nga subjekte te kontraktuara per kete qellim.
- Sistemi i shkarkimit te ujerave urbane te jete i lidhur me sistemin e kanalizimeve te zones, fillimisht me rrjetin ekzistues, ne rast se dote ndertohet i ri.
- Vendosja e sinjalistikes gjate kohes se punimeve, per shmangien e aksidenteve, si dhe sinjalistikes rrugore ne fund te procesit te punimeve.
- Aplikimi i sistemit te ndri imit me llamba LED.
- Orientimi i trafikut te krijuar ne nje rruge tjeter, si dhe levizja e mjeteve te kryhet ne rruge me dy sense levizje me qellim shmangien e bllokimit te rrugeve.
- Respektimi i orareve te qetesise publike dhe te mos pun oh et ne oret e vona.
- Automjetet e transportit te qarkullojne me shpejtesi te ulet ne zonat e banuara.
- Gjate transportit te perdoren mushamate e kamionave per te shmangur perhapjen e dheut e te inerteve ne rruget e qytetit.

Besmira Niko
Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'

- Te shmangen ore e pikut te trafikut per transportin e materiel eve ndertimore.
- Automjetet e transportit te lahen dhe pastrohen ne menyre periodike para daljes nga kantieri apo nga objekti i prodhimit te betonit.
- Te sigurohet menjehere nje vend i miratuar nga autoritetet per depozitimin e mbetjeve inerte qe duhet te largohen nga objekti.
- Subjekti te jete ne dijeni te gjithe kuadrit ligjor per mjedisin dhe detyrimeve qe lindin ne zbatim te tij.
- Punimet e rehabilitimit te kryhen branda afatit te punimeve te paracaktuar.

Persa i perket rehabilitimit te mjedisit, investitori, vete ose nepermjet firmes ndertuese te kontraktuar, pas perfundimit te ndertimit te infrastruktures perkatese, do te kryeje rehabilitimin e plote te siperfaqeve te demtuara, duke i shtruar ato me beton, asfaltobeton ose pllaka. Ne perfundim te projektit, do te krijohet nje pamje me e kendshme, nje zone me e paster nga pluhuri dhe balta, si dhe do te lehtesoje dhe permisoje jeten e banoreve te kesaj zone. Persa i perkete mbjelljes se bimesise, ne kete projekt nuk jane parashikuar te mbillen peme, per nje faktor te rendesishem, qe eshte mungesa e theksuar e hapesires, madje ne disa segmente, e pa mjaftueshme edhe per te krijuar ne te dyja anet e rruges vendkalime per kembesoret (trotuare).

Ekspert Mjedisi **Ekspert Mjedisi**

Administrator

Besmira Niko

Digitally signed by Besmira Niko
Date: 2026.02.23 12:37:04 +02'00'